EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5506
E enjte, 21 qershor 2018
çmimi 0.40 €

## Pacolli demanton zyrtarët e Serbisë: Liberia nuk e ka tërhequr njohjen

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI HASHIM THAÇI KA MBAJTUR KONFERENCË ME GAZETARË, NË TË CILIN KA FOLUR PËR FAZËN FINALE TË DIALOGUT KOSOVË - SERBI FAQE 4-5

# Presidenti fton partitë për përfshirje në dialogun Kosovë - Serbi



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar të mërkurën partitë politike të bëhen pjesë e dialogut me Serbinë në fazën finale të këtij procesi. Para takimit që do ta zhvillojë me homologun serb në Bruksel të dielën, shefi i shtetit ka thënë se është e domosdoshme të krijohet një delegacion gjithëpërfshirës i Kosovës. Ai në një konferencë me gazetarë ka vlerësuar se arritja e marrëveshjes historike me Serbinë është e domosdoshme për synimin e Kosovës që të bëhet anëtare e OKB-së, për ta përshpejtuar integrimin në BE dhe në NATO. Ndërkaq përfaqësuesit e partive politike, në një tryezë të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në të cilën është folur për dialogun Kosovë - Serbi, nuk kanë treguar përafrim rreth arritjes së konsensusit politik për dialogun

## Hoxhaj: Themelimi i Asociacionit, paralelisht me anëtarësimin në OKB



Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të bëhet paralelisht me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Kështu ka deklaruar të mërkurën zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj gjatë raportimit në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Ai ka folur edhe për marrëveshjet që do të arrihen me Maqedoninë Veriore, me ç'rast ka thënë se temë kyçe është lehtësimi i kalimit të pikave kufitare në mes të dy vendeve FAQE 3



## LDK-ja sërish kërkon konsensus për zgjedhje të reja

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pas përfundimit të tryezës me partitë politike, e ftuar nga Partia Socialdemokrate (PSD), ka parashtruar kërkesën që të arrihet konsensus politik që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Sipas kësaj partie, koalicioni qeverisës e ka futur vendin në krizë FAQE 7

### AKTUALE

**RETORIKA FRYTDHËNËSE KLANORE APO MASKIM TRADHTIE PËR STATUSIN E KOSOVËS?** F. 13



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

**FIGURA EMBLEMATIKE E UKSHIN HOTIT PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SHQIPTARE** F. 12



Afërdita DERVISHI, PhD(c)

### EKONOMI

**SFIDAT AKTUALE TË PRODHUESVE VENDORË** F. 12



Burim PIRAJ

**KORPORATA AMERIKANE DO TË HAPË 1 000 VENDE PUNE NË KOSOVË** F. 8

### KULTURË

**POEZI** F. 13



Nga Genta SAHITI

### SPORT

**FLAMURI I KOSOVËS DO TË VALOJË NË TARRAGONA TË SPANJËS** F. 19

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Parlamenti i Maqedonisë ratifikon marrëveshjen për emrin me Greqinë

Me marrëveshjen e miratuar në Parlament, shteti emërtohet Maqedonia e Veriut, e që synon ta mbyllë kontestin i cili zgjat më shumë se dy dekada mes dy vendeve fqinje dhe ka mbajtur të bllokuara proceset integruese për Maqedoninë




**Shkup, 20 qershor** - Me 69 vota për dhe asnjë kundër, Kuvendi i Maqedonisë ka ratifikuar marrëveshjen e arritur ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Me këtë marrëveshje shteti emërtohet Maqedonia e Veriut, marrëveshje kjo që synon ta mbyllë kontestin, i cili zgjat më shumë se dy dekada mes dy vendeve fqinje dhe ka mbajtur të bllokuara proceset integruese për Maqedoninë.

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, pak para se të votohej ratifikimi, tha se dëshiron të ndajë një lajm të gëzueshëm, duke thënë se sapo është njoftuar se Këshilli i NATO-s ka votuar që si pikë e rendit të ditës në samitin e radhës, të jetë zgjerimi i Aleancës dhe dërgimi i ftesës për anëtarësimin e Maqedonisë.

Kryeministri Zaev para deputetëve edhe të mërkurën ka theksuar se me këtë marrëveshje nuk preket identiteti i maqedonasve, ndërkohë që hapen shumë perspektiva për të ardhmen e shtetit në procesin e integrimeve. "Me këtë zgjidhje të kontestit jo vetëm se fitojmë edhe një mik, jo vetëm se fitojmë edhe një partner strategjik, jo vetëm se i hapim dyert e NATO-s dhe BE-së, jo vetëm se garantojmë stabilitetin dhe sigurinë e vendit po njëherësh, ajo që është më e rëndësishmja, realizojmë aspiratat shekullore të të parëve tanë të të gjitha etnive që kanë luftuar për këtë Maqedoni tonën, që përfundimisht ajo të njihet si shtet nga e gjithë bota; ku pjesa dominuese e popullatës është ajo maqedonase e njohur nga e gjithë bota; shtet ku flitet gjuha maqedonase e njohur nga e gjithë bota. Ky është një akt historik dhe me votimin në Parlament pas tri dekadash për këtë çështje shumë të rëndësishme do të mund të vendosin qytetarët me votën e tyre në referendum", tha Zaev.

Në seancën plenare, në të cilën u miratua ratifikimi i Marrëveshjes Maqedoni - Greqi nuk ishin të pranishëm deputetët e partisë më të madhe maqedonase VMRO DPMNE-së. Ata të martën lëshuan Parlamentin duke theksuar se nuk dëshirojnë të jenë pjesë e procesit që ka tradhtuar interesat e Maqedonisë si shtet.

Ndërkaq, deputeti i VMRO DPMNE-së, Dragan Danev, tha se pushteti ka shkelur të gjitha procedurat për miratimin e Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes Maqedoni - Greqi dhe për këtë arsye VMRO DPMNE-ja do të kërkojë edhe interpretim kushtetues nga Komisioni i Venecias për marrëveshjen.

Por, deputeti i socialdemokratëve, Konstadin Konstadinov, tha se qytetarët deputetëve ua kanë dhënë besimin që t'i zgjidhin problemet dhe jo të ikin nga të njëjtat. "Sot zgjidhim një çështje, e cila më shumë se dy dekada na ka tërhequr në fund. Para nesh kemi një marrëveshje që na garanton atë që ishim edhe më parë, maqedonas, po tani marrëveshja garanton që ky identitet të njihet nga e gjithë bota, përfshirë këtu kombësinë maqedonase, gjuhën maqedonase", tha Konstadinov.

Ndërsa Artan Grubi nga BDI tha se me këtë marrëveshje hapen shumë mundësi për të ardhmen e vendit. Sipas tij, vota pro ratifikimit do të thotë heroizëm, sepse është votë për të ardhmen e Maqedonisë në strukturat euroatlantike.

Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, pas deklaratës së kryeministrit Zoran Zaev për mediet e vendit, se Ivanovi mund të përballet me masën e votëbesimit, në rast se kjo bëhet e domosdoshme, për shkak të kundërshtimit të vazhdueshëm të presidentit për ta dekretuar marrëveshjen, i është kundërpërgjigjur se kryeministri Zaev mund ta fillojë procedurën e votëbesimit, duke theksuar se qëndrimi i tij lidhur me marrëveshjen Maqedoni - Greqi mbetet i pandryshueshëm.

Gjatë seancës parlamentare ishin të pranishme forca të shumta të policisë speciale. Seanca parlamentare të mërkurën kaloi qetë, ndërkohë që nuk u mbajtën protesta edhe pse ishin paralajmëruar nga organizata të ndryshme, të cilat disa ditë me radhë kanë protestuar kundër marrëveshjes Maqedoni-Greqi.

# Meta kërkon mbështetjen e Hungarisë për nisjen e negociatave

**Tiranë, 20 qershor** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, është takuar me homologun hungarez Janos Ader, me ç'rast shprehu mirënjohjen për mbështetjen e qartë të Hungarisë për integrimin e Shqipërisë në BE.

Deklaratës së përbashkët për shtyp i paraprìu një takim kokë me kokë mes dy krerëve të shteteve, ku u fol mbi marrëdhëniet dypalëshe.

Meta kërkoi mbështetjen e Hungarisë për arritjen e konsensusit brenda Këshillit të BE-së dhe mbështetjen e rekomandimit të Komisionit për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Duke u ndalur në bashkëpunimin dypalësh, presidenti Meta nënvizoi faktin se bashkëpunimi ekonomik e tregtar duhet t'u përgjigjet marrëdhënieve të shkëlqyera politike dhe potencialeve që dy vendet kanë si në pasuri natyrore, po ashtu edhe në ato njerëzore.

Rivendosja e linjës së drejtpërdrejtë ajrore midis kryeqyteteve të të dy vendeve dhe hapja e Dhomës së Tregtisë së Hungarisë në Tiranë do të bëjnë që ky bashkëpunim të rritet ndjeshëm dhe që pas katër vjetëve ta festojmë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me rezultate shumë pozitive edhe në këtë drejtim, tha presidenti Meta.

Presidenti hungarez Áder e siguroi presidentin Meta për mbështetjen e Hungarisë si në drejtim të integrimit evropian, po ashtu edhe për nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka raportuar në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

# Hoxhaj: Themelimi i Asociacionit, paralelisht me anëtarësimin në OKB

Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të bëhet paralelisht me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Kështu ka deklaruar të mërkurën zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj gjatë raportimit në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Ai ka folur edhe për marrëveshjet që do të arrihen me Maqedoninë Veriore, me ç'rast ka thënë se temë kyçe është lehtësimi i kalimit të pikave kufitare në mes të dy vendeve



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë të mërkurën se shteti i Kosovës duhet ta kushtëzojë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe me procesin e anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). "Mendoj se shpejtësia e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të shkojë paralelisht me shpejtësinë e anëtarësimit të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB). Këtë qëndrim e kam ndarë me të gjithë krerët e vendit publikisht. Themelimi de fakto i Asociacionit duhet të bëhet paralelisht me avancimin e statusit ndërkombëtar të Kosovës në OKB. Është kartë kushtëzimi që e kemi. Këtë qëndrim e kam pasur edhe sa kam qenë ministër i Punëve të Jashtme dhe këtë qëndrim kam bërë përpjekje ta shtyj çdoherë përpara", ka deklaruar Hoxhaj gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

Duke iu përgjigjur interesimit të anëtarëve të këtij Komisioni për procesin e dialogut, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se fokusi i të gjithëve duhet të jetë rreth epilogut të këtij procesi dhe jo rreth asaj se kush po shkon në dialog. "Partitë politike në tryezë do të duhej të arrijnë një konsensus se si të shkohet përpara në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, mandej ta dërgojnë një platformë në Kuvendin e Kosovës e cila do të duhej të miratohej nga ana juaj. Teksti që është dërguar fillimisht ka qenë një drafte-rezolutë dhe jo platformë. Ne duhet të jemi më të vëmendshëm rreth epilogut të dialogut sesa kush po shkon në dialog. Në letrën që ka marrë presidenti Hashim Thaçi nga zonja Mogherini, sa unë pashë, përcakton dialogun si fazë të fundit. Domethënë, ka një kalendar kohor për dialogun, i përcaktuar nga BE-ja dhe partnerët tanë perëndimorë. Ne do të shohim se si në këtë kalendar kohor do të përgatitemi dhe do të marrim pjesë sa më mirë", është shprehur Hoxhaj.

Po ashtu, zëvendëskryeministri Hoxhaj i ka njoftuar deputetët për ecurinë e përgatitjeve për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët në mes të Qeverisë së Kosovë dhe asaj të Maqedonisë Veriore, duke thënë se temë kyçe është lehtësimi i kalimit të pikave kufitare në mes të dy vendeve. Me këtë rast, ai ka bërë me dije se dy vendet do ta nënshkruajnë marrëveshjen për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, marrëveshjen për komunikacionin hekurudhor kufitar, marrëveshjen për kontrollin e mallrave strategjike, marrëveshjen për diasporën, marrëveshjen për luftën e trafikimit të qenieve njerëzore, marrëveshjen e njohjes reciproke për patent shofer dhe marrëveshjen për trafikun lokal ndërkufitar.

Hoxhaj ka treguar se do të ketë edhe plan të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë Veriore, bashkëpunim edhe në fushën e gjyqësorit, përkatësisht në çështjet civile dhe tregtare, pastaj në sektorin e energjetikës, memorandum të inspektoratit të farmaceutikës, si dhe një protokoll për një kalendar të përbashkët kulturor në mes të Kosovës dhe Maqedonisë Veriore.

Hoxhaj ka folur edhe për lidhjen e Kosovës në sistemin e gazit natyror, përmes vijës TAP, për hapjen e pikës kufitare në Brod, e cila mund ta lidhë Kosovën me Dibrën, zbritjen e çmimit të roamingut, finalizimin e autostradës "Arbën Xhaferi" nga ana e Maqedonisë Veriore si dhe për kurrikulat e përbashkëta. "Do të duhej të ketë një pako të përbashkët turistike për Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Shqipëri", ka theksuar Hoxhaj, duke shtuar se pa njohje nga Serbia dhe Bosnja, Kosova është kundër tregut rajonal pa dogana.

# Delawie e pret Kurtin në takim



PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është pritur të mërkurën në takim nga ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Greg Delawie, me të cilin ka biseduar për funksionimin e institucioneve në Republikën e Kosovës në përputhje me shtetin e së drejtës dhe parimet e demokracisë në republikën parlamentare. "Sot pata kënaqësinë të takohem me ambasadorin Greg Delawie në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë. Bashkë me ambasadorin Delawie diskutuam për funksionimin e institucioneve në Republikën e Kosovës në përputhje me shtetin e së drejtës dhe parimet e demokracisë në republikën parlamentare. Më tej trajtuam edhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të Kosovës, arsimin e punësimin, si dhe situatën në lidhje me dialogun me Serbinë", ka thënë Kurti. Ai ka bërë me dije se e ka njoftuar ambasadorin Delawie lidhur me qëndrimet e Vetëvendosjes për të gjitha temat që kanë të bëjnë me funksionimin e shtetit të Kosovës. "Ambasadorit Delawie i shpjegova qëndrimet dhe punën e Lëvizjes Vetëvendosje për të gjitha këto çështje. U pajtuam t'i vazhdojmë kontaktet dhe takimet e këtilla edhe në të ardhmen", ka thënë Kurti.

Presidenti Hashim Thaçi ka mbajtur konferencë me gazetarë, në të cilin ka folur për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

# Presidenti fton partitë për përfs



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ftuar të mërkurën partitë politike të bëhen pjesë e dialogut me Serbinë në fazën finale të këtij procesi. Para takimit që do ta zhvillojë me homologun serb në Bruksel të dielën, shefi i shtetit ka thënë se është e domosdoshme të krijohet një delegacion gjithëpërfshirës i Kosovës. Ai në një konferencë me gazetarë ka vlerësuar se arritja e marrëveshjes historike me Serbinë është e domosdoshme për synimin e Kosovës që të bëhet anëtare e OKB-së, për ta përshpejtuar integrimin në BE dhe NATO

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, u ka bërë thirrje publike subjekteve politike që të bëhen pjesë e ekipit negociator, i cili do të dialogojë me Serbinë për fazën finale të këtij procesi. Pas ftesës së përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini, për takimin e ri në Bruksel, shefi i shtetit ka thënë është e domosdoshme të krijohet një delegacion gjithëpërfshirës i Kosovës, i përbërë nga përfaqësuesit e partive politike, shoqëria civile, mediet, ekspertët e fushave të caktuara dhe të punohet bashkërisht. "Mendoj se një gjë e tillë do ta bënte këtë proces shumë më transparent, shumë më kredibil dhe përfundimisht më të pranueshëm dhe të zbatueshëm në rast të arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Jam i gatshëm për t'i trajtuar të gjitha idetë dhe propozimet të cilat do të na bëjnë sërish bashkë, si politikë dhe si shoqëri, për t'u përballur si duhet me sprovën që na pret tash e tutje", ka thënë Thaçi në një konferencë me gazetarë.

Sipas tij, Republika e Kosovës nuk do të jetë e vetme në këtë proces, duke shtuar se përkrah do t'i ketë partnerët e saj më besnikë. "Kosova, si gjithmonë, edhe në fazën finale, do ta ketë mbështetjen e ShBA-së, që është thellësisht e interesuar për arritjen e marrëveshjes finale, gjithashtu edhe shtetet evropiane janë të interesuara për normalizimin e marrëdhënieve", ka thënë Thaçi.

I pari i vendit ka bërë me dije se në bazë të mandatit kushtetues, si president i Republikës e ka obligim kushtetues ta përfaqësojë shtetin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, respektivisht t'i prijë këtij dialogu deri në fund. "Çështja e dialogut me Serbinë dhe e arritjes së kësaj marrëveshjeje ka karakter të interesit kombëtar dhe shtetëror për Kosovën. Për këtë shkak, mendoj se nevoja për arritjen e kësaj marrëveshje je i tejkalon mandatet tona politike të përkohshme, shkon përtej raporteve aktuale midis partive qeverisëse dhe atyre opozitare, duke i bërë jorelevante relacionet afatshkurtra midis politikanëve dhe partive të Kosovës. Kjo çështje na takon të gjithëve. Është interes i të gjithë neve dhe i qytetarëve të

# hirje në dialogun Kosovë - Serbi



Kosovës", ka deklaruar Thaçi. Shefi i shtetit ka treguar për synimet që ka Kosova në këtë fazë të dialogut. "Qëllimi ynë në këtë fazë përfundimtare të këtij dialogu është arritja e marrëveshjes ligjërisht obliguese në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila do të mundësojë normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të dy shteteve. Jam i bindur që ka ardhur koha, që pas bisedimeve të cilat në një mënyrë apo tjetrën po zgjasin tash e njëzet vjet, që të nënshkruhet një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë, me të cilën do të përfundonte një epokë tragjike, mbi njëshekullore, në raportet në mes të dy shteteve dhe popujve", ka thënë presidenti Thaçi. Sipas tij, Kosova nuk ka çka t'i druhet dialogut dhe as epilogut të tij. Ai ka shtuar se Kosova ka dijen dhe guximin të përballet me sfidat e këtij procesi. "Si shoqëri dhe politikë e Kosovës, kemi pasur guximin, dijen, organizimin e duhur, pajtimin në mes nesh, si në Konferencën e Rambujesë, ashtu edhe në Procesin e Vjenës, që përmes negociatave dhe luftës së drejtë ta arrijmë çlirimin e Kosovës, pastaj ta mundësojmë edhe shpalljen e pavarësisë, respektivisht krijimin e shtetit të Kosovës. E di, gjithashtu, që na presin bisedime të vështira, sepse tani synojmë ta përmbyllim këtë proces duke bërë marrëveshjen gjithëpërfshirëse historike dhe politike me Serbinë. Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë është e domosdoshme për synimin tonë që të bëhemi shtet anëtar i OKB-së, për ta përshpejtuar procesin e integrimit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në paktin NATO, për ta siguruar vendin e merituar të Kosovës në arenën ndërkombëtare", ka thënë ai. Thaçi ka paralajmëruar se në këtë fazë do të ndodhë edhe shënjimi i kufirit Kosovë - Serbi. Presidenti ka treguar se Kosova me Serbinë nuk ka pasur kufi në të kaluarën, dhe ka rreth 400 kilometra vijë kufitare. "Do të diskutohet çështja e demarkacionit të kufirit Kosovë - Serbi, do të vihet vija kufitare Kosovë - Serbi për herë të parë në historinë tonë, do të njihet ai realitet dhe në fund do të kërkohen edhe ndryshime kushtetuese edhe në Kosovë, edhe në Serbi, sepse Serbia duhet të bëjë ndryshime kushtetuese për ta hequr Kosovën nga preambula", ka vlerësuar Thaçi.
Presidenti i vendit një ditë më parë ka pranuar ftesën e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini, për takimin e ri me presidentin serb, i cili do të ndodhë të dielën, më 24 qershor, në Bruksel.

## Paritë politike ende larg arritjes së konsensusit politik për dialogun

**Prishtinë , 20 qershor (ER)** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën tryezën "Faza finale e dialogut: këndvështrimi i subjekteve politike", me shefat e grupeve parlamentare të partive politike. Gjatë këtij diskutimi panelistët paraqitën qëndrimet e partive politike rreth fazës së re të dialogut me Serbinë, platformën si dhe përfaqësimin e Kosovës në këtë proces.
Në hapje të tryezës, Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka theksuar se spektri politik vendor duhet të ndërtojë një konsensus për ta mbrojtur sa më mirë interesin shtetëror e që ende nuk është arritur. "KDI-ja më 29 maj i është drejtuar me një kërkesë publike Kuvendit të Kosovës, deputetëve të Kosovës, për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për të diskutuar rreth së ardhmes së dialogut Kosovë - Serbi duke konsideruar rëndësinë që Kuvendi i Kosovës duhet të luajë në këtë proces", ka shtuar ajo.
Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se LDK-ja e përkrah dialogun, por secili individ dhe institucion duhet të qëndrojë brenda kompetencave dhe përgjegjësive që i ka. Hoti ka shtuar se si deputet nuk kanë asnjë informatë se çfarë do të sjellë marrëveshja ligjërisht e obligueshme, nëse do të ridefinohet shtetësia e Kosovës apo nëse do të hapet Kushtetuta.
Ndërkaq Memli Krasniqi, shef i grupit parlamentar i PDK-së, ka theksuar se dialogu me Serbinë nuk ka qenë dhe nuk është zgjedhje e Kosovës, por obligim, veçanërisht në rrugën e integrimit evropian. Krasniqi ka vlerësuar se marrëveshja që do të arrihet do t'i tejkalojë përmasat e një gjenerate, prandaj është e nevojshme të ketë gjithëpërfshirje dhe unitet në këtë proces. Ai ka shtuar se kompromis do të ketë, por ky kompromis, sipas tij, nuk do ta cenojë sovranitetin dhe unitaritetin e Republikës së Kosovës.
Glauk Konjufca, shef i grupit parlamentar i LV-së, ka vlerësuar se agjenda e dialogut nuk duhet të dominohet nga agjenda personale e presidentit Thaçi. Konjufca nënvizoi se presidenti Thaçi nuk ka mandat e as të drejtë të bisedojë në Bruksel. Tutje, Konjufca u shpreh se Vetëvendosje do t'i përdorë të gjitha resurset që i ka në dispozicion për të pamundësuar kompromise të reja të cilat e prekin sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës. Kurse Dardan Sejdiu, shef i grupit parlamentar i PSD-së, ka theksuar se Kuvendi duhet t'i japë dritën jeshile çdo vendimi që ka të bëjë me procesin e dialogut. Ai ka theksuar se procesi duhet të ketë legjitimitet dhe përkrahje kualitative nga Kuvendi i Kosovës, në veçanti të platformës dhe ekipit përfaqësues. Gjithashtu, Sejdiu ka shtuar se duhet të krijohet një komision mbikëqyrës i cili do të siguronte transparencë dhe llogaridhënie të këtij procesi.
Bilall Sherifi, shef i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, u shpreh se e përkrahin këdo që shkon në dialog me kusht që sovraniteti, integriteti dhe unitariteti i vendit nuk cenohen. Megjithatë, Sherifi ka theksuar se një gjë e tillë është pak e besueshme kur kemi parasysh rrjedhën e procesit deri më tani dhe marrëveshjet e arritura në Bruksel. Sherifi ka vlerësuar se procesi nuk duhet të jetë në duart e asnjë individi dhe se duhet të ketë diskutim në Kuvend për marrëveshjet para se ajo të arrihet dhe të sillet për votim.
Ndërkaq Muharrerm Nitaj nga grupi parlamentar i AAK-së ka pohuar se partitë opozitare nuk duhet ta përjashtojnë veten nga ky proces me rëndësi për vendin. Nitaj ka kërkuar që mos të bëhen kalkulime politike për të përfituar nga kjo situatë derisa theksoi se Kuvendi duhet ta ketë çelësin në dorë të këtij procesi.
Ky diskutim u organizua në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" që përkrahet nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.



# Bytyqi: Do të punojmë për përgatitjen cilësore të mësimdhënësve

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të mërkurën në tryezën "Përgatitja cilësore e mësimdhënësve në Kosovë", e cila kishte për qëllim diskutimin për programet e përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë, nevojat dhe kërkesat për mësimdhënës të profileve të ndryshme dhe natyrën e përgatitjes së këtyre mësimdhënësve.
Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se përgatitja cilësore e mësimdhënësve në Kosovë është tema më e rëndësishme për të cilën duhet të diskutohet dhe të punohet, me synim kryesor edukimin modern sipas standardeve më të larta. "Përgatitja cilësore e mësimdhënësve është një mision i shenjtë, sepse ardhmëria e fëmijëve tanë varet nga këta të rinj, të cilët përgatiten nga Fakulteti i Edukimit. Do të marrim një lloj obligimi që të rinjtë tanë t'i përgatisim me shkathtësi të nevojshme dhe edukim cilësor të cilat i kërkon koha dhe sipas standardeve evropiane", ka theksuar ministri Bytyqi.
Ministri Bytyqi ka kërkuar bashkëpunim sa më të afërt ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Fakultetit të Edukimit dhe partnerëve ndërkombëtarë, në mënyrë që investimet kryesore të orientohen në fushën e edukimit, me prioritet arsimin parauniversitar. "Një bashkëpunim i ngushtë dhe një zotim i përbashkët do t'i tejkalojë të gjitha sfidat dhe sistemi arsimor në Kosovë njëherë e përgjithmonë do ta marrë drejtimin e duhur dhe brenda pesë vjetëve të ardhme nuk do të diskutojmë më për një nivel të ulët të cilësisë, por për përfitimin e metodave dhe teknikave të reja mësimore, përvetësimin dhe aplikimin e tyre në shkollat tona", është shprehur Bytyqi.
Ministri Bytyqi ka theksuar se GIZ-i, si mbështetës i aktiviteteve të ndryshme në fushën e edukimit, është një nga partnerët tanë për rrugëtimin e sistemit të edukimit në Kosovë. Tryeza është organizuar nga Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.



# Pesë shtetas të Kosovës përfundojnë burgun pasi luftuan në Siri dhe Irak



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Personat që kanë vuajtur dënimin për pjesëmarrje në luftëra të huaja nuk po priten mirë dhe po stigmatizohen nga shoqëria e Kosovës. Kështu ka thënë Lulzim Fushtica, koordinator nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës për parandalimin e ekstremizmit.
Sipas tij, deri tash kanë përfunduar vuajtjen e dënimit pesë persona, të cilët kanë marrë pjesë në konfliktet e armatosura në Siri dhe Irak. "Sipas disa hulumtimeve që janë bërë, një pjesë e madhe e popullatës nuk i pranon dhe nuk i sheh me sy të mirë këta persona që kthehen në shoqëri. Ata stigmatizohen dhe nëse ne si shoqëri nuk i pranojmë, këta prapë mund të kthehen në problem", ka thënë Fushtica në një tryezë mbajtur të mërkurën me disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, në të cilën u fol se si të parandalohet ekstremizmi. "Duhet të punohet në dy fusha, në fushën që ai person të riintegrohet dhe të bëhet i dobishëm për shoqëri, por duhet të punohet edhe me nivelin komunal dhe me komunitetin që ky person të jetë i pranueshëm", ka thënë Fushtica.
Problem tjetër, sipas tij, janë gratë dhe fëmijët që gjenden ende në vatrat e luftës. Sipas policisë, nga viti 2012 e deri më 2016 rreth 359 qytetarë të Kosovës, përkatësisht 255 burra, 49 gra dhe 55 fëmijë kanë shkuar në zonat e luftës në Lindjen e Mesme. Po ashtu, 41 fëmijë kanë lindur në zonat e luftës, 133 qytetarë të Kosovës janë kthyer, 74 kanë vdekur dhe 195 ende mbesin atje (59 burra, 41 gra dhe 95 fëmijë).

## FSK-ja mbështet Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në Kosovë, për nder të Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut (14 qershorit), të mërkurën në Sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë ka organizuar Javën e Dhurimit Vullnetar të Gjakut.
Java e Dhurimit Vullnetar të Gjakut ka filluar më 18 qershor dhe do të përfundojë më 22 qershor. "Për rëndësinë që ka sigurimi në kohë i gjakut dhe produkteve të tij, gjatë kësaj jave do të jetë në fokus edhe falënderimi për të gjithë dhuruesit vullnetarë të gjakut të cilët me dhurimin e gjakut të tyre shpëtojnë jetë çdo ditë. Këtij aksioni vullnetar iu bashkuan shumë pjesëtarë të FSK-së, qytetarë të shumtë, kalimtarë të rastit, por edhe grupe të organizuara që me vullnetin e mirë i ishin përgjigjur këtij aksioni", është thënë në njoftimin e FSK-së.
FSK-ja edhe këtë vit e ka mbështetur Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut me mjete logjistike. Në Sheshin "Nënë Tereza" ka ngritur një tendë për të gjithë vullnetarët që dhurojnë gjak. Aksionit iu përgjigjën një numër i madh i pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe përgjatë vitit në mënyrë të organizuar dhurojnë gjak. Qindra doza gjak grumbullohen nga këta pjesëtarë për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës.



Mbahet tryeza politike e organizuar nga Partia Socialdemokrate (PSD)

# LDK-ja sërish kërkon konsensus për zgjedhje të reja

**Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pas përfundimit të tryezës me partitë politike, e ftuar nga Partia Socialdemokrate (PSD), ka parashtruar kërkesën që të arrihet konsensus politik që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Sipas kësaj partie, koalicioni qeverisës e ka futur vendin në krizë**

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Pas përfundimit të tryezës me partitë politike të ftuara nga Partia Socialdemokrate (PSD), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dalë me një deklaratë për medie, përmes së cilës ka vlerësuar se humbja e shumicës nga koalicioni qeverisës që ndodhi para tre muajsh e ka futur vendin në krizë. "Ky vlerësim i para tre muajve është edhe më aktual tani, pasi kriza është thelluar. Qeveria nuk mund të adresojë asnjë çështje madhore, përveç vendimeve rutinore të cilat mund t'i marrë edhe një qeveri teknike në detyrë. Kuvendi është jofunksional. Tryeza e partive politike është iniciuar nga LDK-ja me një temë të vetme që është si të dilet nga kjo krizë institucionale. Në një situatë të tillë ne nuk mund të bisedojmë për tema të tjera", është theksuar në deklaratën e LDK-së.

Sipas kësaj partie, temat e rëndësisë nacionale nuk mund të adresohen nga një koalicion i pakicës. Prandaj, sipas LDK-së, për të dalë nga kjo situatë zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme. "Është në interesin e qytetarëve që partitë politike të arrijnë konsensus lidhur me: parimet që duhen ndjekur për adresimin e këtyre temave të rëndësisë nacionale, pavarësisht kush qeveris sot e kush nesër, si dhe caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme dhe përgatitjet e nevojshme për të nxjerrë një qeveri stabile të një shumice. Në frymën e kësaj, LDK-ja është e gatshme të bisedojë dhe të arrijë konsensus. Ndryshe këto tryeza nuk kanë kuptim. Ne do t'i përdorim rrugët kushtetuese për të mos lejuar dëmtimin e vendit nga ky koalicion qeverisës i pakicës", është theksuar në deklaratën për medie të LDK-së.

Në këtë tryezë është propozuar që procesin e dialogut me Serbinë ta udhëheqë Kuvendi i Kosovës. "Duke marrë parasysh që dialogu po merr një agjendë të madhe të politikës, ne kemi propozuar që dialogun ta udhëheqë Kuvendi i Kosovës, themelimi i një komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e dialogut, ku ekipi negociator do t'i raportojë. Nëse mandatohet nga Kuvendi, ky i fundit mund ta shkarkojë këdo. Nuk e dimë se pse po shkohet në dialog. Nuk ka pajtim të subjekteve politike me këtë tekst", ka thënë, pas përfundimit të tryezës, kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti.

Ai ka theksuar se dialogu është një proces i rëndësishëm dhe se për këtë proces duhet të këtë pajtim të subjekteve politike. "Ne do të tentojmë të mbajmë takime bilaterale me subjektet politike dhe të shohim se cilat janë qëndrimet dhe a mund të kemi një tekst që së paku të pajtohemi për procesin, e që kjo do ta hapte rrugën pastaj që të prezantohet një platformë shtetërore për negociatat", ka deklaruar Ahmeti.

Kurse shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, pas përfundimit të tryezës, ka bërë me dije se sot kanë pasur një takim shumë konkret, në të cilin është diskutuar për një temë që është shumë aktuale dhe e rëndësishme, atë të dialogut me Serbinë. Ai ka theksuar se konsensusi për dialogun me Serbinë është shumë i dëshirueshëm. Sipas Krasniqit, gjithëpërfshirja në këtë proces është e nevojshme. "Duhet të pajtohemi sa më shumë që mundemi ndërmjet pozitës dhe opozitës për procesin e dialogut", ka deklaruar Memli Krasniqi.



# Pacolli demanton zyrtarët e Serbisë: Liberia nuk e ka tërhequr njohjen



PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka demantuar lajmin e zyrtarëve të Beogradit, se Liberia ka tërhequr njohjen për Kosovën. Pacolli ka bërë me dije se ka zhvilluar një bisedë telefonike me zyrtarët e lartë të Liberisë, të cilët, sipas tij, ia kanë konfirmuar se ky shtet nuk ka ndryshuar qëndrimin karshi shtetit të Kosovës. "Sapo zhvillova një bisedë telefonike me udhëheqësit e lartë të Qeverisë së Liberisë, të cilët ma konfirmuan që tërheqja e njohjes së Republikës së Kosovës nuk është e vërtetë. Prandaj është për keqardhje që Beogradi zyrtar vazhdon të investojë përpjekje të kota në propagandë destruktive për konsum të brendshëm në Serbi. Në ditët në vijim, marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Liberinë do të kulmojnë në nivelin më të lartë diplomatik", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Lajmi, kinse për tërheqjen e njohjes nga Liberia, është bërë publik në mediet serbe dhe nga ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq.

# Sfidat aktuale të prodhuesve vendorë



**Burim PIRAJ**
Mastër i Administrimit të Biznesit Ndërkombëtar

Kosova si një vend me ekonomi që ende nuk i ka mbushur dy dekada dhe me një treg 1.5 milion banorë ka nevojë për një përkushtim më të madh të institucioneve vendimmarrëse që të mëkëmbët.

Pas shumë sfidave të natyrës politike, infrastrukturore, të mungesës së energjisë elektrike dhe atyre të natyrës së ligjeve ekonomike të cilat e kanë ngulfatur ekonominë e vendit, tani ekonomia, sidomos shtresa e cila merret me prodhim dhe përpunim në vend, po ballafaqohet me një rrjet tregtar të ndërtuar tanimë në Kosovë, i cili i tejkalon shumëfish nevojat e konsumit të popullatës.

Ky tejkalim i kërkesave të konsumatorëve i ka dhe anët negative të veta, të cilat dalëngadalë po i prekin kompanitë prodhuese vendore me prolongim të pagesës së borxheve, gjë që kompanitë vendore mund të dobësohen financiarisht në atë masë saqë të mos mund të zhvillohen më tej.

Së këndejmi, çdo ditë po favorizohen me prodhime të importuara, për arsye se produktet që importohen paguhen avanc nga kompanitë importuese dhe ata vrapojnë t'u japin sa më shumë hapësira në marketet e veta për ta mundësuar kthimin e mjeteve derisa prodhimet vendore kanë afat pagese deri në 90 ditë në disa raste, plus u kërkohet rabat ekstrem për t'i ekspozuar në market.

Në këso situate kanë qenë shumë vende në zhvillim dhe në këto raste është dashur intervenimi i institucioneve vendore që prodhimit vendor t'i jepet vendi i merituar në markete.

Masat që janë marrë nga vende të ndryshme në botë janë si në vijim:

- Imponimi i furnizimit me prodhime vendore, së paku 50 % nga vlera totale e artikujve në market;
- Vendosja me ligj e pagesave të brendshme dhe detyrimi i pagesës nga organet shtetërore ashtu që të ruhet raporti furnitor-blerës, shteti si palë e tretë ta detyrojë pagesën në afat.

Në bazë të ligjeve në fuqi, pagesa e borxhit nuk është shumë problematike sepse mund ta zbatojnë përmbaruesit privatë, mirëpo në raste të tilla prishet raporti tregtar dhe atëherë kompanitë tregtare i lartojnë të gjitha prodhimet e firmës e cila e përdor përmbaruesin për t'i kthyer borxhet e papaguara;

- Kontrolli i rreptë i deklaratave të prodhimit, sepse shumë prodhime që shiten në Kosovë nuk i kanë deklaratat e sakta, për arsye se në ëmbëlsira dhe në jogurt të ndryshëm fshihet përmbajtja e xhelatinës e cila kryesisht është me prejardhje nga derri dhe në shumë prodhime të mishit përmbajtja e mishit në gjuhët e huaja shkruan vetëm si mish, a në shqip përkthehet mish viçi i cili nuk përkon aspak me përmbajtjen, prandaj këto mospërputhje kanë ndikimin e vet në konkurrueshmëri sepse çmimet i kanë më joshëse për blerësin e Kosovës.

Çdo zyrtar, çdo individ, çdo qytetar duhet ta kuptojë se mundësimi i shitjes së prodhimeve vendore e përmirëson standardin jetësor në vendin tonë, prandaj kontributi i çdokujt është shumë i nevojshëm që ta ndryshojmë gjendjen e cila kohë të gjatë në Kosovë nuk po prodhon stabilitet ekonomik dhe stabilitet social.

# Korporata amerikane do të hapë 1 000 vende pune në Kosovë

**Prizren, 20 qershor (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar të mërkurën në Prizren përfaqësuesit e korporatës së njohur amerikane "Sutherland Global", e cila merret me procesimin e shërbimeve biznesore. Kjo kompani ka ardhur të investojë në Kosovë, ndërsa do të hapë mbi 1 000 vende të reja pune në fushën e IT-së.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se në kontaktin e tij të parë me këtë kompani i ka inkurajuar drejtuesit e saj të vijnë dhe të investojnë në Kosovë. Veseli ka treguar se sot kjo kompani numëron 150 të punësuar, ndërsa brenda dy vjetëve të ardhshëm edhe 1 000 të tjerë. "Ne shumë shpejt do ta kemi liberalizimin e vizave, por ne duhet të punojmë që rininë ta mbajmë në Kosovë dhe perspektivën ta ketë këtu", ka theksuar Veseli. Sipas tij, Dekada e Re është dekada e teknologjisë informative dhe e të rinjve të Kosovës. "Sikur këtë kompani, inkurajoj edhe kompani të tjera që të vijnë dhe të investojnë në Kosovë. Kosova ka rini të mrekullueshme, punëtore, të talentuar, optimiste dhe kreative", është shprehur Veseli.

Ndërsa zëvendësdrejtori i kompanisë, Ks Kumar, ka thënë se të gjitha shërbimet që ofron kjo kompani u ofrohen kompanive më të mëdha në botë. Ai ka treguar se ndihet i kënaqur që për katër muaj të operimit të saj në Kosovë, kompania ka arritur të punësojë 150 të reja dhe rinj kosovarë. "Falënderoj kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe për mbështetjen e ofruar. Ky është vetëm fillimi. Besoj se për një periudhë prej 18-24 muajsh do të jemi në gjendje të ofrojmë edhe 1 000 vende të reja pune për kosovarët", ka thënë Kumar. Ai ka shprehur besimin se me mbështetjen e institucioneve do



të krijohen vende të mira pune dhe do të organizohen trajnime për të rinjtë, të cilët do të jenë të gatshëm për këto vende pune.

# Fillojnë parapërgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve



**Prishtinë, 20 qershor (ER)** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka filluar parapërgatitjet e fushatës së korrje-shirjeve për vitin 2018. "Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve, MBPZhR më 18 qershor ka mbajtur takimin e përbashkët me përfaqësues të drejtorive komunale për bujqësi, përfaqësues të Shoqatës së Prodhuesve të Grurit dhe përfaqësues të Shoqatës së Mullisëve. Bazuar në statistikat e grumbulluara nga terreni, konstatohet se gjendja e sipërfaqeve të mbjella me drithëra të bardha, në veçanti me grurë, është e kënaqshme dhe nga 74 313 ha sipërfaqe, pritet rendiment mesatar rreth 4 000 kg/ha", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Sipas këtij njoftimi, procesi i korrje-shirjeve pritet të fillojë në ditët e fundit të muajit qershor ose në fillim të muajit korrik, varësisht prej kushteve klimatike që do të mbizotërojnë në ditët në vijim. "Në gjithë territorin e vendit me drithëra të bardha këtë vit janë mbjellë dhe pritet të korren 83 155 ha tokë bujqësore, ndërsa numri i autokombajnave të cilat janë në dispozicion dhe pritet të angazhohen në fushatën e korrje-shirjeve është 1400", është thënë në njoftimin e MBPZhR-së.

# Gërxhaliu: Mosliberalizimi i vizave po i ngufatë bizneset tona

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se mosliberalizmi i vizave është duke i ngulfatur bizneset e Kosovës. Ai ka thënë 39 për qind e bizneseve kanë zvogëluar aftësinë konkurruese për shkak të mosliberalizmit të vizave, kurse 44 për qind kanë humbur klientët ndërkombëtarë nga shkëputja e kontratave për shkak të mungesës së lëvizjes së lirë

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, në një konferencë për medie ka apeluar që të hiqen vizat për afaristët nga Kosova pasi, sipas tij, 39 për qind e bizneseve kanë zvogëluar aftësinë konkurruese për shkak të mosliberalizmit të vizave. "39 për qind e bizneseve kosovare kanë zvogëluar aftësinë konkurruese për shkak të mosliberalizmit të vizave, kurse 44 për qind kanë humbur klientët ndërkombëtarë nga shkëputja e kontratave për shkak të mungesës së lëvizjes së lirë. Në këtë drejtim nuk i bëhet nder ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik, pasi koston e getoizmit po e paguan sektori privat. Kemi kompani që kanë parqet e veta në shtete të jashtme, por që për shkak të transportit dhe lëvizjes së lirë janë të kufizuara", ka thënë ai.

Sipas Gërxhaliut, pasojat më të mëdha nga mosliberalizmi i vizave po i bartin biznesi dhe shoqëria, por jo edhe klasa politike e cila ka pasaportë diplomatike. "Pasojat më të mëdha janë ndikimi tek efektet ekonomike, politike, ngadalësimi i proceseve integruese, getoizmi i tillë po ndikon në aspektin kulturor, edukativ dhe psikologjik. Në Kosovë kemi 1 500 përpunues druri dhe është e pamundur operimi i tyre i mirëfilltë në shtetet e tjera, sepse duke filluar nga shoferi e tutje duhet të aplikojnë për vizë", ka thënë ai.




Gërxhaliu ka shprehur indinjatën e tij ndaj Ambasadës së Austrisë në Shkup, e cila, sipas tij, ndaj kosovarëve dhe bizneseve po sillet në mënyrë jodemokratike. "Personeli i Ambasadës së Austrisë në Shkup ka qasje të brishtë ndaj nesh. Kjo nuk është në kohezion me demokracinë", është shprehur ai.

Edhe afaristi Suad Tafleshi ka treguar sfidat me të cilat përballet biznesi i tij. "Ne kemi linjën vendore dhe ndërkombëtare dhe shoferët tanë duhet të aplikojnë për viza vazhdimisht në mënyrë që të mund të punojnë. Nga 12 shoferë sa kishim tani, janë vetëm dy që kanë viza. Apeloj tek institucione e vendit dhe Oda Ekonomike e Kosovës që të jenë të zëshme në këtë drejtim", ka thënë Tafleshi.

# Hasani takon Begajn, flasin për projektet në Malishevë



MALISHEVË, 20 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, i shoqëruar edhe nga shefi i kabinetit, Durim Limaj, të mërkurën kanë vizituar Komunën e Malishevës, ku janë pritur në takim nga kryetari i kësaj komunë, Ragip Begaj dhe bashkëpunëtorët e tij. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë njoftimi me ecurinë e projekteve në Komunën e Malishevës dhe krijimi i mundësive për zhvillim më të madh ekonomik.

Begaj pasi e ka njoftuar ministrin Hasani për rrjedhat e përgjithshme në Komunën e Malishevës, e ka njoftuar edhe me projektet që është duke i realizuar komuna, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të kushteve për investime në Malishevë. Ndërsa ministri i MTI-së, Bajram Hasani, fillimisht e ka përgëzuar kryetarin Begaj për punën që është duke u bërë në Malishevë dhe ka premtuar përkrahjen e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht ministrisë që ai drejton. Hasani ka thënë se qëllimi i MTI-së është që në të gjitha komunat e vendit të krijohen mundësi më të mëdha për investime.

Po ashtu, Begaj dhe Hasani janë pajtuar të vazhdohet bashkëpunimi në mes Komunës së Malishevës dhe MTI-së me projekte të përbashkëta, me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim më të madh ekonomik.

## Ministri Hasani u premton mbështetje verëtarëve

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, të mërkurën ka marrë pjesë në Rahovec, në forumin e verërave e organizuar nga Shoqata e Verëtarëve të Kosovës "Enologjia". Ai ka thënë se është i lumtur që industria e prodhimit të verërave po shënon suksese në vazhdimësi dhe, sipas tij, eksporti është dyfish më i lartë se importi.

"U premtova verëtarëve se si ministër i Ministrisë së Tregtisë do ta vazhdoj edhe më tej përkrahjen e këtij sektori", ka thënë ministri Hasani. Ai ka shtuar se MTI-ja në vazhdimësi i ka mbështetur verëtarët, duke u mundësuar pjesëmarrje në panaire të ndryshme ndërkombëtare.

# Jashari shkon për ngushëllime në familjen Haradinaj



GLLOGJAN, 20 QERSHOR (ER) - Me rastin e ndarjes nga jeta të Hilmi Haradinajt, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët, ka vizituar të mërkurën në Gllogjan familjen Haradinaj. Në profilin e vet në "Facebook", Jashari ka shkruar se baca Hilmi ishte shembull i prindit të pathyeshëm, me vendosmërinë e pamposhtur për qëllimet më fisnike dhe më të sinqerta në shërbim të atdheut.

# 'Qatar Charity' dhuron katër motokultivatorë për fermerët mitrovicas



PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Në kuadër të subvencionimit në bujqësi, organizata "Qatar Charity", në Komunën e Mitrovicës, të mërkurën ka shpërndarë katër motokultivatorëve për fermerët, përkatësisht bujqit mitrovicas. Ky subvencionim bëhet me qëllim të ndihmës në zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Mitrovicës.

Vlera totale e këtij subvencionimi arrin shumën 6 400 euro, duke përfshirë edhe pajisjet shtesë të motokultivatorëve, frezë, kosa dhe një rimorkio.

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Ekrem Sadiku, ka falënderuar organizatën "Qatar Charity", e cila po ndihmon zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në bujqësi. "Këto pajisje do t'u ndihmojnë fermerëve për aktivitetet e përditshme në bujqësi, si dhe për ngritjen e kualitetit dhe produktivitetit të prodhimeve. Përkrahja për bujqësi do të vazhdojë edhe në të ardhmen edhe nga organet komunale, duke subvencionuar dhe mbështetur në vazhdimësi fermerët", ka thënë Mujka.

# Nis asfaltimi i rrugës katër korsi Gjilan - Livoç i Ulët

GJILAN, 20 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Gjilanit ka nisur të mërkurën asfaltimi i rrugës hyrëse dhe dalëse me katër korsi, Gjilan - Livoç i Ulët, e cila ka gjatësi mbi tri kilometrash dhe gjerësi prej 20 metrave. Gjatë vizitës në teren, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, është shprehur i lumtur që po realizohet ky projekt kapital. "Jam shumë i lumtur që sot filluam këtë projekt kaq të rëndësishëm në vlerë prej dy milionë eurosh. Zgjerimi i rrugës do të shkojë deri në qendër të qytetit, tek semaforët, e që realisht e integron në zonën urbane Livoçin e Ulët. Rruga po bëhet sipas standardeve, me zonën e gjelbër, infrastrukturën përcjellëse nëntokësore dhe ndriçimin publik", ka deklaruar Haziri. Ai ka bërë me dije se së shpejti do të fillojë edhe ndërtimi i rrugës tjetër hyrëse dhe dalëse Gjilan - Prishtinë në gjatësi prej tri kilometrash, që fillon nga tuneli e deri në fshatin Livoç i Epërm.



## Rrugë e re në lagjen "Kalabria"

Prishtinë, 20 qershor (ER) - Komuna e Prishtinës shumë shpejt do ta fillojë ndërtimin e rrugës së re në lagjen "Kalabria", rrugë kjo drejt dy objekteve të rëndësishme që do të ndërtohen në këtë lagje. Përmes kësaj rruge objekti për fëmijët me Down Syndrome dhe ata me autizëm që do të ndërtohet nga TIKA, si dhe çerdhja e re e lagjes që do të ndërtohet nga Komisioni Evropian, do të kenë qasje në rrugën kryesore afër Stacionit të Autobusëve.



Nuk ka bisedime me Serbinë pa u evituar Kosova nga preambula e kushtetutës serbiane

# RETORIKA FRYTDHËNËSE KLANORE APO MASKIM TRADHTIE PËR STATUSIN E KOSOVËS?



**Prof. dr. Hakif BAJRAMI**

Në Ballkan, pas shembjes së komunizmit, do të fillojë të vlojë uji në akull. Krime të papara do të ndodhin në shtetin hibrid të quajtur Jugosllavi. E tërë kjo tragjedi do të ndodhë me nxitjen tinëzare të Rusisë, e cila brenda saj do të shembet, sidomos në veri ku nuk pati guxim të reagojë sepse me dhunë i kishte përvetësuar dhe me fuqinë imperiale ku "Ariu i Sibirit" do ta shfryjë tërë urrejtjen në jug të vendit. Për ta zvogëluar vëmendjen e shteteve të demokracisë perëndimore, Rusia e kuqe nga krimet do të gjejë një aleat të "vjetër" në synimet koloniale të Serbisë integrale me synime çetnike-komuniste për homogjenitet të popullit të "qiellit".

E vërteta, shqiptarët që ishin populli më i nëpërkëmbur në Jugosllavinë titiste me kohë kishin dëshmuar se synojnë krijimin e një republike të barabartë me të tjerat, që edhe ashtu nuk ishin pa armiqësi në mes tyre. Për të sqaruar këtë realitet, duhet ta themi se në të gjitha republikat ngjyrimin ideologjik dhe kombëtare, po dhe shtetësinë e kishin kushtetutshmëri dhe simbolikë dhe retorikë sllave. Dhe kur filloi kriza shtetërore dhe ideologjike, t'i tregoi shenjat e ndarjes së sllavëve, shqiptarët do të ndryshojnë qëndrim nga lufta demokratike qytetare për republikë të Kosovës brenda Jugosllavisë. Shqiptarët si popull i tretë do të orientohen jo me konflikt qytetar, për ta ndryshuar regjimin në Beograd, por do të rreshtohen që me luftë të ndërtojnë kapacitet ushtarake për Kosovën Republikë sovrane. Kuptohet, se sovraniteti nuk faktorizohej pa një luftë të drejtë, e cila nga dukja guerile do të kthehet në frontale, aq sa i kishte kapacitetet. Në fakt, lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe vetëm si e tillë ngadalë por me shumë kthesa do ta meritojë edhe intervenimin e NATO-s, për 78 ditë luftë "eksperimentale", e cila jo zyrtarisht u quajt humanitare e më së pakut ishte e tillë sepse para Evropës plasohej modeli i ri neofashist serbian për shtypje të popujve të tjerë, fakt ky që me asnjë çmim nuk guxonte të bëhej realitet. Në fakt Klintonit, Blerit, Shirakut dhe Solanës i ishte shpjeguar se nuk e kanë sulmuar kurrë shqiptarët (ishin populli numerikisht ma i fuqishëm gjatë shekullit XIX në tërë Ballkanin-hb): as Cetinën, as Kralevën, as Sofjen e as Athinën. E kundërta ka ngja, këto shtete principata kurdo që patën fuqi nuk kursyen asgjë për të na shfarosë: I okupuan viset shqiptare me fuqinë e kryqëzatës evropiane, por edhe me krimet dhe tradhtinë e Padishahut. Pra, pse Padishahu i "dashur e vëlla" i paska shkatërruar dy principatat shqiptare (1821-1830?) - Pashallëkun e Janinës dhe të Shkodrës; pse "vllau anadollak" i preu në besë më 1830 nga valiu kriminal 500 politikanë shqiptar në iftar në Manastir; pse e luftoi me zjarr e me top çdo shkendi shqiptare për shkollë dhe shtet kombëtar si kryengritjet 1842-1868; Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1877-1886; pse..; pse më 1908-1912 me të gjitha mjetet ua nguli thikën pas shpine pikërisht shqiptarëve; pse më 1938 bëri Konventë për të na shfarosë si arnautë, ashtu si planifikonte Serbia më 1935(Konferenca ndërministrore), 1938-1944 (Konventa Jugosllave-Turke); më 1953-1966 (Marrëveshja xhentëlmenë, në mes kriminelit Tito dhe shqiptarit shartuar Fuad Kyprili më 1953 në Split; Pse, pse..)

Pas mbarimit të Luftës në Kosovë (1998/99), çarqet serbiane që ishin skuqur në gjak dhe gjenocid faktik mbi shqiptar, do të vihen në fron me një Rezolutë të KS OKB, serbianët do ta komentojnë se e kishin lëshuar Kosovën përkohësisht dhe gjithnjë sipas saj (Rezo.nr. 1244 të KS OKB) do të kthehen një ditë triumfalisht,sepse e paskan fituar prej turkut më 1912?!. Për ta realizuar këtë skenar me prapavijë, në veprim do të vihet i tërë arsenali politik dhe ushtarak i Rusisë së mbetur, por edhe një segment i Brukselit. Këtij arsenali ngadalë do t'i bashkëngjitet tërthorazi edhe Kina, India dhe Indonezia që i kanë nga 30-40 Kosova Brenda si realitet. Këtij skenari nja dy vite tinzishtë do t'i bashkohet edhe Turqia (për shkak të Kurdëve) madje duke shpresuar se në truallin e "plagosur" të Ballkanit, ka vend për të shpresuar për kthim iemperial të ish kohës së Perandorisë (lexone Duatogllun që e solli avionin spiun dhe i grabiti 6 shtetas për të na hasmuar me tërë botën e civilizuar..). Kështu do të fillojë Ankaraja (Dautogllu, "Thellësia e një strategjie".. dhe Moska (Putin, Maskota ruse me gjemba imperial, i pa publikuar…) të ëndërrojnë se në çdo situate të ndryshimeve në Ballkan, do të fitojnë me kamatë, sepse spektri politik i Kosovës ishte tmerrësisht i përçarë, në dy tabore, në atë "krahu i pacifizmit" që mendonte se çdo gjë varet nga faktori i jashtëm, dhe krahu i luftës që ishte "made in Albania etnika". Kësaj filozofie do t'i sigurojë fole kriza kanceroze finansiare në Greqi, për çka Anadollia kërkonte t'i shiten disa qindra ujdhesa që i kishte fituar Greku më 1923, e tani duhej t'i shërbenin për larje borxhesh. Dhe, kështu filloi loja e "kompensimit të historisë", sidomos në Kosovë, ku pushteti drejtohej nga UNMIK e vendorët taetrizonin pavarësi solide, e Rusia i plasonte spirancat e spiunazhit pa pengesa në Tiranë. Shkup, Prishtinë dhe Podgoricë?. Kështu politikanizmi do të fillojë dhe do të frontohet në Kosovën e izoluar, ku shumë ashpër partitë regjionale janë në modë, sa që "Krahu i luftës" në Kosovë, do të paditet me "argumente" të rrejshme në Hagë, se duhet i tëri në stilin e kriminelëve serbian si përgjegjës sui generis për tragjedinë në vend, edhe këta duhej të përgjigjeshin bile edhe për largimin masiv të shqiptarëve nga Kosova!!!. Në këto baza, nga viti 2004 e deri më 2007 vetëm sa nuk thuhej publikisht në Bruksel se: "Shqiptarët duhet t`i kërkojnë falje Serbisë" e pushtetarët tanë gati të njëjtit që janë sot blefonin demokraci evropiane dhe miqësi të sinqertë me Vatikanin edhe pse Kardianli deklaronte se "I kemi marrëdhëniet e shkëlqyera me Kishën Serniane". Deri këtu kishte arritur tehu i shpatës kryqëzatë sllavo-"kapitaliste". Në dokumentet e dërguara në Hagë, shteti i së cilës do të krijojë një industri "turistiko-politike" nga gjyqtarët, hetuesit, avokatët dhe mediet, e më së shumti me agjenturat e spiunimit, ku do thyhen decidivisht "shpatat", se po të qëndronin shqiptarët ashtu si propagandonte LDK-ja, dhe si ishin pajtuar prijësit e saj më 15 maj 1998, me Milloshin në Beograd, spastrim dhe rrënime, madje edhe dhunime dhe serbizim të Kosovës, "nuk do të kishte", sepse paska "funksionuar një sistem paralel i "pushtetit shpëtimtar" ledekeist!!.Trashu rrenë dhe tradhti trashu. Dhe kjo kastë "historike" nuk e dinte se ai sistem mund të shkapërderdhej për dy orë, por jetonte sepse çdo familje i paguante taksat më mirë dhe ma në rregull se në çdo etapë tjetër të ish regjimit gjakatar jugosllav. Këtij sistemi forcash politike me një strategji finoke, diku aty kah fundi I vitit 1999 apo 2004, do t'i bashkëngjitet edhe Kina, duke menduar se përmes Kosovës do të kthehet edhe një here në oazën e Ballkanit. Mjerisht, këtë hapësirë të veprimit politik në rrethin që do të shpërthehet më 2017 në trust veprimi nën tezgë: Rusi- Turqi-Kinë-Indi-Iran, do ta hetojë me shumë vonesë binomi politik: BE dhe SHBA (B Obama), sepse mendonin se me triumafalizëm kishin siguruar çdo gjë. Në fakt, këtë greminë gjeostrategjike që ishte instaluar në Kosovë, Kosova do ta paguaj shumë shtrenjtë dhe kështu me qëllim do të mbetet vendi ma i izoluar në Evropë. Këtë realitet të stërkonsumimit të politikës pacifiste e shfrytëzoi Rusia e tentim atentateve, së cilës iu bashkuan edhe dy-tre drejtues të një partie fantom, madje me vonesë sepse politika e jashtme e SHBA-ve nuk ishte e zgjuar por, do ta hetojë vetëm kur erdhi XH. Ë. BUSH në Tiranë më 10 qershor 2007. Aty njeriu numër një i superfuqisë botërore, do ta kuptojë realitetin. Dhe aty për aty do të shpërthej duke publikuar se: Kosova duhet të avancohet në Republikë. Tani janë në sprovë përballja e muskujve në mes Rusisë, Turqisë, Kinës me një anë dhe BE (EULEX) dhe SHBA-ve në anën tjetër ku Kosova ishte në mes, e ku ndrydhja mestazonte përmes Serbisë me ëndrra imperial. Kjo politikë triviale e Moskës, do të varet nga ekipi I Kosovës, që do t` i drejtojë negociatat "teknike", të cilat më së pakut janë të tilla nga fillimi, sepse çdo gjë bëhej për ta "fjetur Kosovën", për ta kthyer të fjetur në "shtratin" kolonial serbian. **(Vijon)**

## Të shtunën në Gjilan nis faza e parë e dezinsektimit hapësinor

Gjilan, 20 qershor (ER) - Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë, të shtunën fillon fazën e parë të dezinsektimit hapësinor, e cila përfshin qytetin si dhe zonat përreth tij, me qëllim të shfarosjes së mushkonjave dhe insekteve të tjera të bezdisshme për qytetarët.

Drejtori i Shëndetësisë në këtë komunë, Selami Xhemaili, ka njoftuar se kjo fazë e dezinsektimit do të bëhet nga ora 20:00 deri në orën 24:00 dhe do të zgjasë tri ditë me radhë. Ai ka kërkuar nga bletarët që gjatë kohës sa zgjat aksioni për dezinsektim, t'i mbajnë të mbyllura bletët e tyre, në mënyrë që të mos kenë ndonjë dëm eventual nga preparatet të cilat përdoren për asgjësimin e mushkonjave dhe insektet e tjera të dëmshme.



(Kumtesë e lexuar në tryezën shkencore "Mendimi politik shkencor i profesor Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes kombëtare në kontekstin evropian!" Krushë e Madhe, 17. 6. 2018)

# FIGURA EMBLEMATIKE E UKSHIN HOTIT PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SHQIPTARE



Afërdita DERVISHI, PhD(c)
Hulumtuese shkencore

## Përkufizimi

Në viset shqiptare që kishin mbetur nën ish-Jugosllavi, pas Konferencës së Londrës që copëtoi tokat shqiptare, ishin shumë të rrallë intelektualët që guxonin të merrnin veprime konkrete, në kohën kur shumica kishin frikë të shihnin, madje edhe në ëndërr, se çështja shqiptare duhet të zgjidhet. Intelektuali i klasës së parë, i kalibrit të pakrahasueshëm me të tjerët, Ukshin Hoti, ishte ndër të rrallët që pati guximin intelektual dhe atdhetar për ta ofruar qasjen më optimale duke përdorur metoda veprimi që sugjeronin zgjidhjen e çështjes shqiptare në kontekst evropian.

Do të mjaftonte vetëm deklarata e prof. Ukshin Hotit, mbajtur para trupit gjykues, që më 1994, për të kuptuar drejt, për të qartësuar ide dhe mendime të paqarta, për të krijuar koncepte të reja, jo vetëm lidhur me gjendjen kur ai ka shkruar, por edhe me përgatitjen e rrugës për ardhjen e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mënyra se si ai e ka kundërshtuar aktakuzën e atij gjyqi policor e partiak, ideologjik dhe antishqiptar, dëshmon për aftësitë e jashtëzakonshme të Ukshin Hotit, jo vetëm për aktualitetin në të cilin gjendej Kosova e, bashkë me të, edhe autori i deklaratës, por edhe për vizionin e tij për të ardhmen e Kosovës, të bashkimit kombëtar, të Ballkanit dhe të Kosovës në kontekst të Evropës.

Kjo kumtesë është trajtuar duke pasur mbi bazë tri pyetje kërkimore:

1. Cila është filozofia politike e Ukshin Hotit për zgjidhjen e çështjes shqiptare?
2. Cila ishte jehona e veprimtarisë së Ukshin Hotit në vetëdijen kombëtare të studentëve dhe
3. Politika antishqiptare dhe familja

Përgjigjet në këto pyetje sugjestive, mund të përkufizohen duke marrë për bazë të dhënat e dorës së parë të Ukshin Hotit, në formë të shkrimeve, letrave, librave, si dhe të dhënat e dorës së dytë të autorëve të tjerë, duke përdorur metodën e cilësore përmes qasjes normative dhe teorisë epistemologjike, për të hulumtuar origjinën, filozofinë dhe figurën emblematike të Ukshin Hotit, një intelektuali me vizion të përmasave botërore, që diti si të trajtojë identitetin kombëtar shqiptar sipas parametrave të së drejtës ndërkombëtare të njejtë si te kombet tjera, edhe për të vënë në spikamë kompleksin e inferioritetit intelektual, si dhe ndikimin e pushtetit.

## Hyrje

Ukshin Hoti, është marrë me çështjen kombëtare, edhe të bashkimit kombëtar në kohën kur shumicën e intelektualëve i kishte marrë me vete vëllazërim bashkimi. Në njërën nga çështjet që ka shtruar që në vitin 1994, Ukshin Hoti, dalin qartë shumë aspekte të jetës shoqërore të shqiptarëve, që nuk janë plotësuar, ose kanë mbetur në gjysmë të rrugës. Ai thotë: "... Republika e Kosovës t'i njohë si të vetët dhe t'i qaset seriozisht marrjes së përgjegjësisë shtetërore duke i riorganizuar dhe organizuar policinë dhe ushtrinë në pajtim me rendin demokratik të shtetit të saj".

Nëse merret në planin e formimit të Republikës së Kosovës, që ishte kërkesë e Ukshin Hotit, që nga viti 1981, kur mbronte pikëpamjet e tij për mundësinë historike të krijimit të Republikës, mund të thuhet se këtu ishte edhe baza e krijimit të bashkimit kombëtar. Do të thotë, pra, duke zgjidhur njërën nga nyjat kryesore të çështjes kombëtare, krijimin e Republikës së Kosovës, të cilën e kishin kërkuar studentët dhe populli demonstrues, Ukshin Hoti kërkonte që të krijohej, të organizohej dhe të vihej në funksion ushtria e Republikës. Krijimi i Republikës së Kosovës, nëse do të pranohej nga Serbia, siç kërkonte dhe argumentonte Prof. Ukshin Hoti, atëherë ishte jashtë logjikës së kohës, që të merreshe me teoretizime politike, për faktin se Republika, pra shteti, ka të drejtë edhe sipas normave të kodifikuar ndërkombëtare, të cilat Ukshin Hoti i njihte shumë mirë, duke qenë se kishte specializuar në Universitetin e Harvardit, që të organizonte jetën e tij të brendshme, sipas, mundësive, kërkesave dhe rrugës së tij historike. Pra, hapej rruga e procesit të bashkimit kombëtar. Prandaj, me të drejtë prof. Moikom Zeqo thotë se për Ukshin Hotin çështja shqiptare nuk është një mit i rrugës dhe as një fantazi e kabinetit intelektual.

## Filozofia politike e zgjidhjes së çështjes shqiptare

Cila do të ishte qasja ndaj kësaj çështjeje, pra e zgjidhjes së çështjes shqiptare, pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe pas luftërave çlirimtare në Kosovën Lindore dhe në pjesën e Maqedonisë Perëndimore?

Si do ta shpjegonte Ukshin Hoti, me filozofinë e tij të zgjidhjes së çështjes kombëtare, ndikimin e luftës për liri për të larguar frikën e të robëruarve, të cilët, edhe pse në vend të huaj, nën një regjim kolonialist, i besojnë pushkës si e vetmja mundësi për ta fituar lirinë?

Çka ndodh me politikën paqësore evropiane, nëse shqiptarët, nesër a pasnesër, me liderë të tjerë politikë, kërkojnë të bëjnë referendum, që është i lejuar edhe me normat e konventave ndërkombëtare, për të bërë bashkimin e tokave të pushtuara nga të huaj para 100 vjetësh?

Për hir të së vërtetës historike, këtu është vendi të shtrohen çështje, të cilat atëherë kur i ka kërkuar Ukshin Hoti, ishin të dënueshme sipas Kodit penal për vepër armiqësore kundër popullit dhe shtetit.

Kurse sot, në fjalorin politik të pushtetarëve, të partiakëve, të akademikëve, të politikës së ditës, në Tiranë dhe në Prishtinë, ato jo vetëm që nuk përdoren në kuptimin dhe shqyrtimin shkencor që u ka bërë Ukshin Hoti, kur është ndjekur nga Kodi penal, por janë shpëlarje truri e qytetarëve shqiptarë, se na mjaftojnë këto gjysma e këto pjesë që i kemi, vetëm të jemi të parët në to, pra të kemi atë pushtet ku mund të shfrytëzohen njerëzit dhe të mirat materiale që afron pushteti, qoftë edhe i një komune të vetme, qoftë edhe i një krahine të vetme, qoftë edhe i një Republike, siç është aktualisht Republika e Kosovës.

Nëse përcillen me vëmendje ngjarjet historike dhe merren raportet e konteksteve kohore, pra koha kur ka folur dhe ka shkruar Ukshin Hoti dhe koha kur flasin dhe shkruajnë këta shqiptarët e sotëm që u përmendën më sipër, atëherë del se figura emblematike e dijetarit Ukshin Hoti, në zgjidhjen e çështjes shqiptare, ishte jo vetëm e drejtë historike, e argumentuar shkencërisht, por ishte edhe platformë e rrugës për realizimin e bashkimit kombëtar

Ndoshta, vetëm edhe Sami Frashëri i Rilindjes sonë Kombëtare, në veprën e tij madhore, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", kishte analizuar kaq bindshëm, në një kontekst tjetër kohor, çështjen e ruajtjes së tërësisë së tokave shqiptare, të cilat në kohën e Ukshin Hotit, pas copëtimi dhe pushtimit të tyre me forcën e armëve të pushtuesve tanë dhe me pëlqimin e Evropës së kohës, kërkohej të hapeshin rrugët për bashkimin e tyre dhe për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar.

Ukshin Hoti ishte proklamuesi i parë i proceseve demokratike të viteve 80-90 në ish Jugosllavi. Duke mbrojtur demonstratat e vitit 1981, ai u bë zëri i arsyes së kërkesave të studentëve dhe popullit të Kosovës. Në këtë kontekst Akademik Rexhep Qosja shkruan: "Ukshin Hoti - është simbol i vetëdijes historike, i ndërgjegjes dhe i qëndresës së pamposhtur shqiptare. Nuk është e çuditshme pse ky është emri më i kuptimshëm, më domethënës, më frymëzues në jetën tonë politike sot. Dhe, kjo tregon se populli ynë e çmon, ashtu siç duhet, njeriun e gatshëm për sakrifica. Dua të besoj se Ukshin Hoti do të dijë ta mbajë si duhet domethënien gjithëkombëtare, që rrezaton sot emri i tij".

## Politika antishqiptare dhe familja

Citoj një pjesë të shkëputur nga shënimet e Ukshin Hotit: "Atmosfera e rëndë politike në Kosovë megjithatë nuk është vetëm refleksion i luftës në Kroaci, i gjendjes në Jugosllavi, i mosjetësimit akoma të Republikës së Kosovës, por edhe i faktit se gjërat pothuajse ngecën, si dhe i faktit se atmosfera e tillë e rëndë politike tashmë me të dy këmbët është futur në dekadën e dytë. Përse e kemi situatën të këtillë? Përse po zgjat kaq shumë ajo, dhe sa do të duhej pritur akoma? "Të presim edhe dy-tre vjet", u thoshte fshatarëve të mi një titist i flaktë i dikurshëm që u shndërrua tani në një demokrat edhe më të zjarrtë "dhe pastaj do të jetë aq bukur… do të bëhemi të fortë!"

Nuk ka asgjë më të saktë, se kur dijetari i madh, njohësi emblematik i çështjes sonë kombëtare, krijon rrafshin e krahasimit në mes gjendjes në Republikën ende të pabërë të Kosovës dhe të familjes së tij. Për ta mbajtur të izoluar dijen dhe praninë e tij në opinionin e kohës, ata kishin krijuar rrethana që t'ia shkatërronin familjen. Gjendja kishte shkuar deri atje, sa nuk lejoheshin as fëmijët që ta shihnin prindin. Në logjikën kanunore të jetës në Kosovë, edhe mund të kuptohen gjendje të këtilla, por në jetën e një intelektuali, në jetën e një njeriu, fjala e të cilit bëhej veprim kur dënohej me burg, se kishte argumentuar të drejtën e kërkesës së studentëve për Republikën e Kosovës, në jetën e një prindi, të cilit i pamundësohet që edhe të mos e njoh mirë fëmijën e tij, do të thoshte përdorim i të gjitha mjeteve për ta shkatërruar edhe individin, edhe familjen.

Njësoj, si për jetën shoqërore, ecuria e së cilës kishte ngecur në batakun e politikës së kohës, prit dhe duro, ashtu veprohej edhe për mbijetesën e familjes, prit edhe dy-tri vjet, se bëhet mirë... Njësoj flisnin edhe veprimtarët politik të kohës, që dikur kishin qenë ose komunistë të përbetuar, ose shërbëtorë të UDB-së, kurse tashti ishin bërë demokrat e shkuar demokratëve, ishin bërë katolikë, më shumë se Papa, do të thoshte populli.

Të tjerë që shihnin rrezikun nga fuqia e ndritur e mendjes duke e ndjerë veten të dobët përballë Ukshin Hotit, zgjodhën të luftojnë kundër tij me metoda diskriminuese të fshehta, duke e komprometuar dhe kualifikuar me lloj lloj epitete. Këtë në mënyrë brilante do t'a thoshte Ismail Kadare, "Kam frikë se pikërisht ky nivel i lartë ka qenë edhe burim i fatkeqësisë, që e ka ndjekur hap pas hapi këtë martir... Është e papranueshme që një personalitet i një populli, pavarësisht se ç'partie i përket, ose nuk i përket, të mbahet në zinxhirë. Është fyerje për krejt atë popull. Më fort se kurrë, kombi shqiptar ka nevojë për njerëz të aftë e me nivel të lartë. Njerëzit e zotë janë princat e vërtetë të një kombi. Për fat të keq, princat goditen shpesh në mënyrë të vdekshme...

## Përfundim

Po bëhen dy decenie, që Ukshin Hoti nuk u gjet, por ai la shkollën e madhe të filozofisë kombëtare, la idetë e pavdekshme të tij, la frymën e tij që të çon peshë e nuk të le të qetë, për ta dashur atdheun e kombin. Një pjesë e intelektualëve shqiptar, as sot e kësaj dite nuk janë në gjendje të përballen me filozofinë dhe vizionin e tij politik, duke e parë qoftë si oponent politik qoftë si element destabilizues në Universitetin e Prishtinës në vitet e '80-ta e më vonë.

Prandaj është mirë t'i thërrasim ndërgjegjes dhe të pyesim veten tonë: A po e kryejmë siç duhet punën tonë sot sipas konceptit të Ukshin Hotit, kur kemi të gjitha kushtet dhe mundësitë për të jetësuar filozofinë politike të tij për bashkimin kombëtar dhe integrimin e shqiptarëve me popujt tjerë evropian?! A jemi ne në nivelin që ta shikojmë veten drejtë në sy duke dalë para amanetit të dëshmorëve të kombit? Andaj është koha e fundit të ndjekim filozofinë politike dhe konceptet evropiane të Ukshin Hotit për zgjidhjen njëherë e mirë, të çështjes shqiptare.

**(Autorja është profesoreshë universiteti dhe e burgosur politike)**



Genta SAHITI

## T'moçëm jena na

*Përnatë tjerri dashni,*
*përditë fluturoj.*
*Nuk i ndij krahët,*
*janë t'mit a t'qiejve,*
*prej verës.*
*Vera jeme ma ngat se vetja,*
*nuk i vyshk lulet*
*pa pajtue gjysën e shpirtit,*
*pa pajtue gjoksin ku veç nji natë nuk peshon kryet tand.*
*Uh sa t'moçëm jena na!*
*I plakim verat,*
*vitet as i shohim*
*as i thajmë,*
*as i vjetrojmë,*
*as i djegim.*
*I lajmë në det gjethesh,*
*në trungje pemësh,*
*gjelbërimesh i mbjellim me qiparisa.*
*Uh sa t'moçëm jena na!*
*Jetojmë veç n'dashni,*
*aty ku nuk të merret fryma,*
*banojmë veç në një stinë.*
*Vera kurrë nuk ik,*
*nuk iket prej vetes.*
*Nji rrugë me gurë*
*Mbi krye nji qiell*
*mish qe ecën jena*
*Gjak me ujë*
*Dashnin që piqet n'diell*
*nuk e djeg drita e hanës...*
*i thaftë vera te tjerët*

## Fustanbardhat

*Po kaloj për herë te parë*
*kësaj pranvere*
*Me bekue kasollën e shenjtë*
*në çantën e shpinës*
*andrrat janë t'njejtat.*
*Nuk tutna se brenda nji nate, iken lumturia*
*Jam njiheri vajzë*
*Grue*
*Poete*
*Te tria janë të paqta*
*jetojnë*
*mejtojnë*
*ngjasin*
*Veç pranverave kalojnë*
*Dimni nuk ua shkund petalet*
*Fustani i bardhë, ju shkon te trijave*
*Pa e humb veten, lirinë*
*Nuk ngopen kurrë*
*Po deng e kanë mirësinë*
*Askurrë, askujt nuk ia drejtojnë gishtin*
*Fustanbardhat, nuk lindin prej hiçit*
*Kaloj serish mbi pranvera*
*I la me ardh qysh te duen*
*Largohem me lule n'krahnor*
*Tuj k'ndue si zanë*
*besoj se rra'jt i kam*
*thellë...*
*thellë në bardhesi..*

## Zani saj

*M'vjen nji za i ngrohtë prej n'qiell,*
*ma puth gushën, faqet*
*e m'thot ke me u mërdhi!*
*Xhaketën e thurun t'saj*
*e ve mbi sup aty ka prekjen..*
*S'di pse sa herë ia ndij frymën bahem e fortë.*
*Ngre sytë prej qiellit*
*e n'ballë m'vjen bekimi i saj.*
*Lule!*
*M'ka marrë malli!*

## Diku n'pathemel

*Jam ftoh, si mejt e prehem me ftyrë kah perëndimi*
*Sfilitun si dre që e merr etja*
*Nuk e di a lodhesh ti,*
*si na mban kur pshtyjmë n'ty,*
*kur luejmë me zemrat diku n'pathemel*

*Jo, s'ke me u mbush*
*me frymën e urrejtjes që lshuen në ajrin tand steriln,*
*se gjakut t'verbën, s'ke me i ba vend nën damarë,*
*as nrrueza t'bardha…*

# 'Andrra në beze', një libër i rrallë

**Prishtinë, 20 qershor** - Gazetari shumëvjeçar i shumë medieve fizike dhe elektronike të Kosovës, ish-drejtori i Teatrit "Dodona", Agron Shala, ka publikuar librin e parë "Andrra në beze" me Shtëpinë Botuese "Armagedoni".

Në këtë libër prej dyqind faqesh janë përmbledhur njëzet ese nga fusha e kulturës, kryesisht e filmit, për të cilat disa studiues të mediumeve dhe profesorë universiteti kanë dhënë vlerësime të mira, duke i konsideruar esetë e Shalës, tepër të rralla në gjithë ambientin e Kosovës.

Për librin "Andrra në beze" vlerësime, të cilat janë prezantuar në kopertinën e pasme të librit, kanë dhënë profesori i teatrit, romansieri, dramaturgu, regjisori, esteti dhe eseisti Stefan Çapaliku, eseisti dhe ish-editori i gazetës "Zëri", Blerim Shala, profesori i letërsisë dhe gjuhës angleze, Muhamet Hamiti, profesori i fotografisë Fahredin Spahija, publicisti dhe studiuesi Daut Dauti.

### Thanë për librin "Andrra në beze"

"Esetë e Agron Shalës ndërtohen mbi një seriozitet në qasje, thellësi në analizë, pasuri në informacion, kombinim në zhanre, krahasime që bashkojnë të tashmen me të kaluarën. Si të tilla, këto ese janë një dukuri e rrallë, tepër e rrallë në këtë ambientin tonë të kontaminuar me banalitete të të gjitha llojeve, të cilat janë bërë përditshmëri e jona" / Blerim Shala

"Duke dalë prej shtëpie me këtë libër [...] asht ba gati me na dhanë dorën dhe me na përcjellë 'rrokull botës e rrokull Shqypniës së tij' si një person njerëzor e intelektual…" / Stefan Çapaliku

"E veçanta e tij është shoshitja e fenomeneve kulturore nëpër kriteret e sociologjisë , psikologjisë, filozofisë dhe historisë. Ai ofron shpjegime të cilat janë të denja për krahasim edhe me botimet e shtypit më elitar dhe të specializuar të fushës së kulturës në Evropë e gjetiu" / Daut Dauti




"Shkrime 'non-fiction' me nuanca gjuhe fiksionale edhe kur bëhet fjalë për jetën reale, distopike, të sotmes, që bie ndesh me optimizmin e induktuar komunist me dekada në Shqipëri e në Kosovë. Pesimizmi i Agron Shalës për konditën shoqërore shqiptare bëhet njëfarë pharmakos-i i kohës sonë" / Muhamet Hamiti

"Rrëfimi tejet interesant që Agron Shala ndërton duke e analizuar veprën filmike, si lexues të bën të krijosh një lidhje të fortë, gjithsesi emocionale me subjektin që e trajton regjisori" / **Fahredin SPAHIJA**

E rrallë

# Artisti del nga varri pas tri ditësh



Mbrëmjen e së enjtes (14 qershor) një turmë e madhe u mblodh në Hobart të Tasmanisë për të parë një njeri që varrosej i gjallë. Artisti Mike Parr kaloi tri ditë nëntokë pa ngrënë ushqim. Ai do të ketë vetëm ujë, materiale për të skicuar, libër, kovë dhe një stol meditimi. Kjo do jetë një performancë nga ana e tij që quhet "Underneath the Bitumen the Artist" dhe është pjesë e muzikalit të përvitshëm në Tasmani, Dark Mofo.

FOTO E DITES



Një djalë shikon fotografi të albumeve të filmave të fundit në një dyqan në Kibera. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Kapela që u shit për 400 mijë dollarë



Kapela që mbante Napoleon Bonaparti në betejën e Vaterlosë është shitur për 400 mijë dollarë në një ankand në Lyon të Francës. Zotëruesit e ankandit i thanë "CNN"-së se blerësi ishte një koleksionues evropian, pasionant i Mbretërisë së Parë Franceze.

## BARSOLETA E DITËS



**Hoxhë, nëse jam duke u fal dhe më del përpara një arushë, a duhet ta vazhdoj namazin apo të ik?**
**Hoxha: Nëse ki abdes, vazhdoje.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo




**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)




Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**




**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot mos u mërzisni nëse personat pranë jush nuk do t'ju thonë ato që doni të dëgjoni. Më mirë t'ju thonë të vërtetën.



**DEMI**
Jeni përqendruar në një pikë të caktuar dhe do të neglizhoni çdo gjë tjetër rreth jush. Një darkë romantike me partnerin do t'ju kënaqë.



BINJAKËT
Shumë çështje mund t'i injoroni sot, por njëra në veçanti është shumë e rëndësishme për t'u lënë mënjanë.



**GAFORRJA**
Sot mund të ketë shumë keqkuptime që lidhen me sjelljen tuaj hipersensibël dhe me emocionet e dukshme.



**LUANI**
Sot do të kuptoni se pse persona të caktuar kanë kohë që janë larguar nga ju për shkak të sjelljes suaj.



**VIRGJËRESHA**
Jeni pak nostalgjike sot për shkak edhe të kohës, por kujtimet e bukura do të jenë të vetmet që ju vijnë në mend.



**PESHORJA**
Nëse e nisni ditën me këmbën e mbarë, sot do të keni vetëm lajme të bukura gjatë gjithë kohës në vazhdim.



**AKREPI**
Për të vendosur të ardhmen tuaj duhet të zgjidhni patjetër problemet që keni më të tashmen që s'po ju lenë të qetë.



**SHIGJETARI**
Jini më të pranishëm në jetët e personave që doni sepse do të vijë çasti dhe nuk do ta gjeni më vendin tuaj.



**BRICJAPI**
Sot jeni shumë pesimist sepse keni parë që bashkëpunëtorët tuaj po përpiqen ta zvogëlojnë sa të mundin punën që ju bëni.



**UJORI**
Keni një situatë kompromentuese që mund t'ju shqetësojë sot, por nëse veproni natyrshëm çdo gjë do të zgjidhet më së miri.



**PESHQIT**
Edhe durimi juaj e ka një limit, por kjo gjë nuk po kuptohet ende mirë nga ata që ju qëndrojnë pranë.

# Meghan Markle, me kapelën e parë "Royal Ascot"



Një muaj pas dasmës, Meghan Markle ka bërë debutimin zyrtar në ngjarjen e hipizmit më të famshëm në botë. Rasti mondan, i lejon gjithnjë pjesëmarrësit të tregojnë kapele vërtet të veçanta dhe këtë vit u panë modele vërtet të pazakonta. Markle u pa me kapelën e parë "Royal Ascot".

# Eva Longoria sjell në jetë fëmijën e parë




Aktorja Eva Longoria ka sjellë në jetë fëmijën e parë. 43-vjeçarja dhe bashkëshorti i saj Jose 'Pepe' Baston publikuan lajmin e lumtur në faqen e parë të revistës "Hola!" Longoria ka thënë se djali i saj ka ardhur në jetë të martën në mbrëmje dhe shprehet se ai është "një mrekulli e vërtetë".




# Sandra Bullock nuk pranon role filmike me skena seksuale

Sandra Bullock po shijon suksesin me filmin më të ri që po shfaqet në kinematë amerikane "Oceans 8". Aktorja amerikane ka një kriter të madh që ua vendos producentëve para se të marrë një rol në ndonjë projekt filmik hollivudian. Ajo nënshkruan kontrata për xhirimin e ndonjë filmi vetëm nëse nuk duhet të luajë një rol ku ka skena seksuale.

# E dashura e Ronaldos sërish shtatzënë?



Egjithë vëmendja është përqendruar te Cristiano Ronaldo. Ylli portugez shkëlqeu në ndeshjen e parë në Botëror, duke shënuar tri gola, por edhe për shkak të jetës private. Mediet rozë kanë aluduar se e dashura e tij Georgina Rodiguez është në pritje të fëmijës së dytë. Ndërsa u shfaq në një sfilatë mode, ishin format trupore të modelueses që ngritën dyshimet. Georgina ka sjellë në jetë vajzën Alana Martina vetëm pak muaj më parë dhe mbetet për t'u parë nëse ajo është përsëri shtatzënë.










# Urat në Gjermani,
## nga rrënojat romake tek teknologjia moderne




### 1.Trashëgimi romake

Kjo urë mbi lumin Mosel në Trier është ura më e vjetër romake e ruajtur në Gjermani. Fillimisht këtu ka pasur një urë druri, të cilën romakët më vonë e zëvendësuan me një urë me bazament gurësh të sjellë nga zona e Eifelit. Kolonat mbajtëse të urës i përkasin shekullit të dytë. Pjesa e sipërme u ndërtua në shek. 12-të dhe u rindërtua në shek. 18-të pas një bombardimi prej trupave franceze.

### 2.Potencial shpërthyes

Ura e Fehmarnsund-it u inagurua në vitin 1963. Ajo u ndërtua gjatë Luftës së Ftohtë e si rjedhojë në korsitë e saj u integruan gjashtë galeri shpërthyese për rastin e ndonjë invazioni të mundshëm armiqësor. Ura lidh ishullin e Detit Balltik Fehmarn me tokën në pikën verilindore të Gjermanisë.

### 3.E kaluara mesjetare e Erfurtit

Dikur mbi këtë urë tregtarët shisnin mallrat e tyre. Ura Krämer në zonën e vjetër të qytetit të Erfurtit ishte pjesë e Via Regia, e cila kalonte përmes Perandorisë së Shenjtë Romake të Kombit Gjerman. Sot ura mbi lumin Gera është e mbuluar nga të dyja anët nga galeritë dhe punishtet e artizanatit. Çdo vit në qershor këtu organizohet festa e urës „Krämerbrückenfest“ – festë për Mesjetën.




### 4.Rrugë e mbuluar në Zvicër

Disa ura të vjetra druri kanë qenë të mbuluara për mbrojtje nga era dhe moti i keq. Ura e drunjtë në Bad Säckingen lidh vendin me të njëjtin emër në Gjermani me komunën Stein në Zvicër. Ura kalon mbi lumin Rin dhe me gjatësinë prej 204 metrash ajo është ura e drunjtë më e gjatë e mbuluar në Europë.

### 5.Harqe mbi Göltzsch

Zgjerimi i rrjetit hekurudhor në vitin 1800 i përballi inxhinierët me sfida të reja. Ura e luginës së Göltzsch-it, e cila u ndërtua në Saksoni si një Viadukt mbi luginën e lumit, konsiderohej si projekt ambicioz – kryesisht për arsye të madhësisë dhe të harqeve madhështore të saj. Kur ajo u inagurua në 1851 ishte ura më e lartë hekurudhore në botë. Sot kjo është ura më e madhe në botë me tulla.

### 6.Një urë mbi shkëmbinj

Kjo urë të mundëson panoramë spektakolare: Ura Bastei u ndërtua në vitin 1851 në zonën e shpallur sot si park kombëtar Sächsische Schëeiz (Zvicra saksone). Që nga ajo kohë vizitorët kanë mundësi të shëtisin mes dy formacioneve gjigante shkëmbore në lartësinë rreth 200 metra mbi lumin Elbë. Çdo vit në parkun kombëtar vërshojnë turistë në masë për të shijuar pejsazhin me shkëmbinjtë madhështorë.

### 7.Ura e Remagenit

Ura Ludendorff në Remagen ishte gjatë Luftës së Dytë Botërore një pikë e rëndësishme strategjike kalimi mbi Rin për forcat aleate. Në mars 1945 ajo u morr prej trupave amerikane. Dhjetë ditë më pas ura u shemb prej bombardimeve gjermane prej nga gjetën vdekjen shumë ushtarë. Dy kalatë e urës rezistuan dhe u shndërruan në një muze të paqes.

### 8.Dikur ndante dhe sot bashkon

Kur u ndërtua muri i Berlinit në vitin 1961 ura Oberbaumu bën pjesë pranë kufirit mes Berlinit Lindor dhe atij Perëndimor. Ushtarët e armatosur të kufirit patrullonin në brigjet e lumit Spree dhe ishin të dislokuar në pikën e kontrollit mbi urë. Sot kjo urë lidh pjesët e qytetit Friedrichshain dhe Kreuzberg dhe është kthyer në një simbol të ribashkimit gjerman pas rënies së murit të Berlinit.















5



### 11.Harqe mbi Rin

"Dreiländerbrücke", ura mes tri vendeve mbi Rin lidh Ëeil mbi Rin të Gjermanisë me Huningue në Francë. Ura ndodhet në trikëndëshin kufitar Gjermani-Francë-Zvicër, ndaj dhe mban këtë emër. Konstrukti me lartësi 248 m. është ndërtuar në 2007 dhe është ura më e gjatë me harqe në botë e ndërtuar enkas për këmbësorë dhe çiklistë. Në 2008 kjo vepër u vlerësua me çmimin gjerman të arkitekturës.

### 12.Lego gjigante

Kjo urë hekurudhore në dukje modeste dhe për më tepër e lënë djerrë në Vupertal nuk është ndonjë shembull spikatës i një arkitekture të gjetur, por ajo tërhoqi vëmendjen pasi artisti i grafiteve Martin Heuëold në vitin 2011 mori pësipër dekorimin që kjo urë e kishte aq të nevojshme. Artisti punoi me një ekip të papunësh, për të vendosur mbi betonin gri copa gjigante e shumëngjyrëshe legoje.

*(gazeta-Shqip.com)*

### 9.Drynat e dashurisë në Këln

Ura Hohenzollern mbi lumin Rinn në Këln e ndërtuar në vitin 1911, u hodh në erë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe u rindërtua më vonë. Kjo vepër arkitektonike është jo vetëm një arterie e rëndësishme qarkullimi por edhe një vend romancash: dhjetra mijëra çifte për t'i konfirmuar dashurinë njëri-tjetrit mbyllin drynin e tyre në parvazët e urës. Pesha e këtyre drynave llogaritet të jetë dy tonë.

### 10.Urë ujore mbi Elbë

Pas ribashkimit nisi puna për zgjerimin e rrugëve ujore në mbarë Gjermaninë. Kryqëzimi i rrugëve ujore në Magdeburg përfundoi në vitin 2003. Kanali mbi Elbë ua shkurton rrugën anijeve të transportit. Ura 900 m e gjatë e kanalit mbi Elbë është Aquadukti më i gjatë i lundrueshëm në botë.


12




9

# 10 rekomandimet kundër kancerit nga SHBA-të



Dhjetë rekomandime për parandalimin e kancerit, nga aktiviteti fizik në ushqyerjen e duhur, me ftesën e përsëritur për të reduktuar konsumin e mishit të kuq. Dekalogu i fundit i përditësuar vjen nga Fondi Botëror për Kërkimin e Kancerit, i cili publikoi raportin 'Dieta, ushqimi, aktiviteti fizik dhe kanceri: një perspektivë globale'.

"Rekomandimet tona, – shpjegon Martin Wiseman, këshilltar mjekësor-shkencor, – vijnë nga përfundimet e një paneli të pavarur ekspertësh. Ato përfaqësojnë një 'paketë' zgjedhjesh të shëndetshme të jetesës që, së bashku, mund të kenë një ndikim të madh në rrezikun që ka një subjekt për të zhvilluar kancer gjatë jetës".

KËTO JANË REKOMANDIMET:

– MBANI PESHËN E DUHUR: Është e rëndësishme të shmangni mbipeshën dhe obezitetin dhe të kufizoni rritjen e peshës trupore në moshë madhore. Në fakt, mbipesha është një nga shkaqet e 12 tumoreve

– LËVIZ MË SHUMË: ecni më shumë çdo ditë dhe rrini ulur më pak. Në të vërtetë është treguar se aktiviteti fizik mbron kundër kancerit të zorrës së trashë, gjirit dhe endometrit. Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon që të kryeni të paktën 150 minuta aktivitet të moderuar fizik në javë (ecje, not, ose aktivitete shtëpiake) ose 75 minuta aktivitet fizik të fuqishëm (vrapim, çiklizëm, aerobikë). Kujdes edhe për kohën e tepërt të kaluar para TV dhe videolojërave.

– HANI DRITHËRA, FRUTA, PERIME, DHE BISHTAJORE: këshilla është që duhet të hani të paktën 30 gram fibra dhe të paktën 400 gram fruta dhe perime çdo ditë.

– KUFIZONI 'FAST FOOD': vihet gishti kundrejt burgerëve, pulave të skuqura, patateve të skuqura dhe pijeve shumë kalorike dhe me sheqer. Këto janë ushqime që u nënshtrohen proceseve industriale që zakonisht kanë energji të lartë, por reduktojnë mikroushqyesit.

– KUFIZONI MISHIN E KUQ DHE TË PUNUAR: kufizoni gjithashtu konsumin e sallamit dhe proshutës. Nëse hani mish të kuq, konsumi duhet të kufizohet në jo më shumë se tre porcione në javë, ekuivalente me rreth 350-500 gram mish të gatuar.

– KUFIZONI PIJET ME SHEQER: më mirë pini ujë ose pije pa sheqer, duke përfshirë çaj dhe kafe pa sheqer të shtuar. Kafeja, vënë në dukje ekspertët, ndoshta gjithashtu ka një efekt mbrojtës kundër kancerit të mëlçisë dhe endometrialit. Lëngjet e frutave duhet të konsumohen në sasi të kufizuara.

– I THONI JO ALKOOLIT: ka dëshmi se alkooli është ndër shkaqet e kancerit në gojë, faring, ezofag, mëlçi, zorrës së trashë, gji dhe stomak. Nuk ka prag të konsumit të alkoolit nën të cilin rreziku i kancerit nuk rritet, të paktën për disa forma.

– MOS PËRDORNI SHTESA PËR PARANDALIMIN E KANCERIT: nuk ka prova të forta shkencore që shtesat ushqimore – përveç kalciumit në rastin e kancerit kolorektal – mund të zvogëlojnë rrezikun e kancerit. Për shumicën e njerëzve, ekspertët paralajmërojnë, ka më shumë gjasa që ushqimi dhe pijet e shëndetshme të mbrojnë nga ky rrezik sesa shtesat.

– USHQENI ME GJI NËSE ËSHTË E MUNDUR: laktacioni mbron nënën nga rreziku i kancerit të gjirit dhe fëmijët që ushqehen me gji nga mbipesha dhe, rrjedhimisht, nga format e kancerit për të cilat mbipesha është një shkak.

– PAS DIAGNOZËS SË KANCERIT, NDIQNI REKOMANDIMET: njerëzit që kanë kapërcyer kancerin duhet të udhëhiqen nga regjimi i tyre ushqimor dhe aktiviteti fizik nga specialistët e fushës.

*(gazeta-Shqip.com)*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DENMARK - AUSTRALIA | 1 | FRANCE - PERU | 1 | ARGENTINA - CROATIA | X2 |

# Flamuri i Kosovës do të valojë në Tarragona të Spanjës

Ekipi Olimpik i Republikës së Kosovës do të marrë pjesë në lojërat mesdhetare "Tarragona 2018" me 40 sportistë në 12 sporte të ndryshime, me ç'rast është bërë e ditur edhe lista e sportistëve dhe trajnerëve që do ta përfaqësojnë vendin tonë. Risi e këtij ekipi do të jetë edhe Majlinda Kelmendi, e cila nuk do të marrë pjesë në cilësinë e sportistes, por do të jetë e pranishme si trajnere bashkë me trajnerin e vet Driton Kukën

"Epoka e re"



**PRISHTINË, 20 QERSHOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën ia ka dorëzuar solemnisht flamurin e Kosovës Ekipit Olimpik të Kosovës, i cili për herë të parë do ta përfaqësojë Kosovën në lojërat mesdhetare "Tarragona 2018" që mbahen në Tarragona të Spanjës.
Presidenti Thaçi ka thënë se numri i sportistëve tanë që po marrin pjesë në gara ndërkombëtare është duke u rritur çdoherë e më shumë. "Për herë të parë po përfaqësohemi zyrtarisht nga 40 sportistë, 13 trajnerë dhe 4 gjyqtarë", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se "prej 4-5 sportistëve sa na kanë përfaqësuar më herët, tash kemi arritur në 40 sportistë dhe vitin tjetër do të jemi edhe më tepër".
Kreu i shtetit ka thënë se flamuri i Republikës së Kosovës do të valojë në ceremoninë e hapjes dhe mbylljes së këtyre lojërave. "Do të lartësohet sa më shumë prej sportistëve tanë si simbol shtetëror i fitoreve të tyre, fitoreve tona", u shpreh presidenti Thaçi, duke u uruar suksese sportistëve.
Ndërsa kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se përtej kënaqësisë që pranuan flamurin e Republikës së Kosovës është edhe ndjenja e krenarisë që flamuri ynë do të valojë në Tarragona. "Nga zemra dëshiroj t'ju falënderoj për përkrahjen e përhershme dhe ju premtojmë se edhe ne do të mundohemi ta prezantojmë Kosovën në mënyrë të dinjitetshme dhe ta ngrehim sa më lart imazhin e Republikës së Kosovës", ka shtuar ai.
Duke folur në emër të sportistëve, kampionia e shumëfishtë botërore në xhudo, Majlinda Kelmendi, ka theksuar se ndihet mirë për faktin se është një numër i madh i sportistëve që do të marrin pjesë në lojëra mesdhetare, në krahasim me numrin që ka qenë në Rio. "Është kënaqësi jashtëzakonisht e madhe për mua ta pranoj flamurin", ka thënë ajo, duke shprehur besimin se sportistët do ta përfaqësojnë denjësisht shtetin tonë për herë të parë në lojërat mesdhetare.
Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" mbahen prej 22 qershorit deri më 1 korrik në Tarragona të Spanjës.

### LISTA E SPORTISTËVE DHE TRAJNERËVE QË DO TA PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË "TARRAGONA 2018":

Xhudo: Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Loriana Kuka dhe Laura Fazliu. Trajnerë: Driton Kuka, Majlinda Kelmendi
Karate: Herolind Nishevci, Alvin Karaqi, Orges Arifi, Fortesa Orana, Adelina Rama. Trajner: Isak Curri.
Not: Dasar Xhambazi, Dion Kadriu, Dren Ukimeraj, Eda Zeqiri, Fjorda Shabani. Trajner: Ardian Hamiti.
Boks: Besfort Merlaku, Dielli Vranoci, Patriot Behrami, Violant Sylejmani. Trajner: Shefki Bogujevci.
Atletikë: Astrit Kryeziu, Gresa Bakraçi, Musa Hajdari, Vijona Kryeziu. Trajner: Zijadin Kryeziu
Shigjetari: Ardita Zejnullahu, Atdhe Luzhnica, Hazir Asllani. Trajner: Fehmi Bylykbashi.
Tenis: Blearta Ukëhaxhaj, Burim Bytyqi, Granit Bajraliu. Trajner: Jeton Hadërgjonaj.
Volejboll në rërë: Armend Berisha, Faton Mustafa, Valmira Ramadani, Vildane Jashari. Trajner: Abedin Ibrahimi.
Pingpong: Fatih Karabaxhaku, Kreshnik Mahmuti, Mentor Shabani. Trajner: Baton Çitaku.
Taekwondo: Butrint Ejupi, Qëndrim Sejfijaj. Trajner: Nuhi Gashi
Peshëngritje: Leonora Brajshori. Trajner: Uzeyir Haciyev.
Shenjëtari: Nexhat Sahiti. Trajner: Bislim Musliu.



# Vihet gurthemeli i Qendrës së Mjekësisë Sportive në Prishtinë

**PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER)** - Në ambientet e Qendrës Klinike Universitare (QKUK) të mërkurën është vënë gurthemeli i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive.
Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se Majlinda Kelmendi dhe sportistët e tjerë na kanë bërë krenarë deri më sot dhe, sipas tij, tani është radha e institucioneve të tregojnë kujdes për ta dhe shëndetin e tyre.
Ismaili ka thënë se është i lumtur që gurthemelin e Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive e bëri kampiona olimpike Majlinda Kelmendi me sportistët e tjerë. "Kjo qendër do të jetë moderne, me kushte optimale që sportistët tanë të ekzaminohen dhe të kujdesen për shëndetin e tyre", ka thënë ministri Ismalili.

## Feronikeli përforcon mesfushën me Alush Gavazajn

**DRENAS, 20 QERSHOR (ER)** - Pas përforcimeve të bëra në mbrojtje e sulm, KF Feronikeli po rrit edhe nivelin e mesfushës. Transferimi më i ri i Feronikelit është mesfushori Alush Gavazaj, i cili në stinorin e kaluar ka luajtur për Lirinë e Prizrenit. Gavazaj është 23-vjeçar, megjithatë karriera e tij ka filluar shumë herët. Përveç Lirisë, ai ishte pjesë edhe e Korabit të Peshkopisë, Tërbunit të Pukës, KF. Tiranës, FK. Bylis Ballsh dhe Shkëndijës së Tiranës.



## Hector Cuper do të largohet nga Egjipti



KAJRO, 20 QERSHOR - Trajneri i Egjiptit, Hector Cuper, do të largohet nga kombëtarja afrikane, pas fundit të Kampionatit Botëror. Lajmin e kanë bërë me dije gazetarët egjiptianë të cilët gjenden në Rusi të akredituar.
Federata Egjiptiane e Futbollit ka vendosur të mos e rinovojë bashkëpunimin me teknikun argjentinas pas zhgënjimit në "Rusi 2018".
Egjipti ka humbur nga Uruguai dhe Rusia, ndërsa e ka edhe një ndeshje me Arabinë Saudite. Pikërisht ndeshja ndaj arabëve do të jetë e fundit për Cuperin si trajner i Salahut me shokët e tij. Cuper është trajneri i parë që do të largohet shkaku i rezultateve të dobëta në Kampionatin Botëror.

# FFK-ja: Prioritet mbetet rinovimi i stadiumit të Prishtinës

PRISHTINË, 20 QERSHOR (ER) - Me një minutë heshtje në nderim të ish-presidentit Fadil Vokrri, ka filluar të mërkurën mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së nën drejtimin e nënpresidentit Agim Ademi. Në këtë mbledhje u theksua se vdekja e presidentit Vokrri është një humbje e madhe për futbollin e Kosovës. "Komiteti Ekzekutiv mendon se duhet të vazhdohet edhe më me ngulm për realizimin e projekteve dhe objektivave të saj dhe të gjitha atyre projekteve që i kishte synuar ish-presidenti dhe ky Komitet Ekzekutiv, madje duke ndjerë obligim të dyfishtë", është thënë në njoftimin e FFK-së.
Komiteti Ekzekutiv në këtë mbledhje ka shqyrtuar gjendjen e përgjithshme në futbollin e Kosovës. "Të martën krerët e FFK-së u takuan me zyrtarë dhe inspektorë të UEFA-së, të cilët vizituan stadiumin e Prishtinës, ku shfaqen shqetësimet e tyre për rrjedhën e punimeve, duke sugjeruar një angazhim më të madh të FFK-së, MKRS-së dhe punëkryerësit në mënyrë që punimet të përfundojnë sa më parë. KE bisedoi se duhet të vazhdohet për fillimin e implementimit të projekteve të ndërtimit të 12 fushave si dhe Qendrës Teknike Stërvitore në Obiliq. KE gjithsesi mendon se top prioritet edhe më tutje mbetet rinovimi i stadiumit të Prishtinës si domosdoshmëri për ndeshjet kualifikuese për Ligën e Kombeve të Kombëtares 'A'", është thënë në njoftimin e FFK-së.





# Ronaldos i mjaftojnë katër minuta me Marokun

MOSKË, 20 QERSHOR - Portugalia ka arritur ta rrëmbejë fitoren e parë në kampionatin e sivjetmë të Botërorit që po mbahet në shtetin rus. Portugezët triumfuan në stadiumin Luzhniki Arena të Moskës kundër kombëtares së Marokut me rezultat 1-0, ku vendimtar ishte goli i Cristiano Ronaldos. Ky i fundit në minutën e katërt kaloi në epërsi kombëtaren e vet pas një goli të shënuar me kokë, ku asistues ishte Joao Moutinho. Njëkohësisht, ky ishte edhe goli i 85 i CR7 duke bërë që ta thyejë rekordin e 62-vjeçarit Ferenc Puskas, i cili ka realizuar 84 gola në 89 paraqitje për Hungarinë.

# 'Beckham' i Islandës, më i bukuri i Kupës së Botës

MOSKË, 20 QERSHOR - Është shpallur fituesi i turneut paralel dhe jozyrtar i bukurisë në mesin e lojtarëve të përfshirë në Botërorin "Rusi 2018". Nuk ishte e domosdoshme që të përfundonte raundi i parë dhe që të gjitha ekipet të zbrisnin në fushë për të kuptuar se kush është lojtari më i pashëm. Ai është Rurik Gislason. Islandezi, 30 vjeç, me sy të kaltër, flokë të gjatë biond të mbledhura në një bisht dhe me një trup statuje. Që kur ekipi i tij kombëtar zbriti në fushë, duke marrë një barazim të habitshëm ndaj Argjentinës së Leo Messit, profili i tij në rrjetet sociale është në rritje, sidomos në mesin e tifozëve argjentinas. Suksesi që nuk vjen aspak i papritur shihet edhe nga ngjashmëria e tij me David Beckham. Një lum vlerësimesh dhe pëlqimesh që i lejojnë atij ta mposhtë konkurrencën e Neymarit, Hummelsit apo Cristiano Ronaldos.



## Pas 17 vjetësh, Jack Wilshire largohet nga Arsenali

LONDËR, 20 QERSHOR - Jack Wilshire ka njoftuar se këtë verë do të largohet nga Arsenali duke i dhënë fund karrierës 17-vjeçare te klubi londinez. Trajneri Unai Emery ia ka bërë të qartë mesfushorit se nuk e ka të garantuar pozitën e tij në skuadër, prandaj 26-vjeçari ka bërë një deklarim publik përmes rrjeteve sociale duke e konfirmuar largimin porsa t'i përfundojë kontrata në fund të këtij muaji. "Konfirmoj se do të largohem nga Arsenali kur të më skadojë kontrata në fund të qershorit. Pas bisedave të stërzgjatura me përfaqësuesit e klubit, në veçanti pas takimit me trajnerin e ri Unai Emery, mendoj se nuk pata shumë për të zgjedhur, pos të marr këtë vendim për arsye të pastra futbollistike", ka shkruar Wilshire në rrjetet sociale.



| Autor: GAZMEND MORINA | ATDHETARI DHE SHKRIMTARI NË FOTO | RREGULL E CAKTUAR LIGJORE OSE MORALE (shq.) | EMRI I KOMANDANT “KUMANOVA” (UÇK) | TEFIK OSMANI | NGJALLJE E KUJTIMEVE PËR DIKË | TONI ADAMS | EPOKA E RE | ALBANOLOGIA DURHAM | DOLLAP I VOGËL QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR ZOGJ | KRYEQYTETI JORDANEZ | LUMË NË SHQIPËRI | UMA TURMAN | ROTHERHAM | EPOKA E RE | KAFSHË E VISEVE TË AMERIKËS SË JUGUT (sh.shq.) | VEPËR KU SHËNOHESHIN VIT PËR VIT NGJARJET MË TË RËNDËSISHME TË KOHËS (sh.shq.) | BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM | | | | | | | E PASUR | | | | | | | HARK; KTHESË / SECILA NGA PJESËT E NJË NDËRTESE (pashq.) | | | |
| SHTETI YNË | | | | | | | GRUA A VAJZË QË VALLËZON ME NJË KAVALIER (sh.shq.) / NJË LLOJ PIJE ALKOOLIKE | | | | | | QYTETI FRANCEZ I FILMIT / PËRÇUES I NJË QËLLIMI A PIKËSYNIMI (fig.) | | | | |
| SHKODRA, RIZONI, MITROVICA | | | | ZANORE | | SHKENCËTARI YNË GJOTA / RUANDA, UGANDA | | | | | | THIKË QË MBAHET NË KËLLËF SI ARMË BREZI (sh.shq.) / FINLANDA, ESTONIA | | | | | |
| PËREMËR PRONOR | | | | BANOR I NJË QYTETI NË SHQIPËRI / QYTET NË ILIRI (shq.) | | | | | | | VDEKJEPRU-RËSE / LIVORNO | | | | | | |
| METAL I BUTË ME NGJYRË TË BARDHË SI TË ARGJENDIT | | | | | | | | KAMBANË E VOGËL (sh.shq.) | | | | | | VITI I RI KINEZ (pashq.) / HEROI ISA | | | |
| BASHKËTING-ËLLORE | | GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat. - sh.shq.) | INVA MULA / SHKENCA MBI PAQENË | | |  | | | | | | SHKRONJAT E PARA | | | “TENERIFE” / HEROI ISMAIL | | |
| BIMË QË MBILLET E RRITET NË NGASTRA ME UJË | | | | | GOTA PREJ METALI (shq.) | | | | | | | LEARNING ORIENTATION QUESTIONNA. | | | | TROPOJA / UJËRA TË FËLLIQURA, QË DALIN NGA LARJA E SHPËLARJA E ENËVE | |
| NJË LLOJ LETRASH FATI | | | | | | | | | | | | SËMUNDJA E TOKËS, EPILEPSIA (pashq.) / ORGAN QENDROR I SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË GJAKUT TE NJERIU (pashq.) / AKTORJA AMERIKANE PORTMAN | | | | | RENS ISTVUD |
| AKTORJA JONË CAHANI | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARJA GJONI / EMRI I KOMANDANTIT LEGJENDAR të UÇK-së | | | | | | | | | | | | | | | | |
| BABAI | | | | ISTRES / KRAHINË NË KOSOVË | | | | | | | | | | | | | KËNGËTARI YNË SHEHU |
| FUTBOLLISTI PORTUGEZ (Chelsea) | | | | | PAGJAKËSI | | | | | | | PRIJËS I HUNËVE / OKSIGJEN, NIKEL, RADIUM | | | | | |
| FAZA | | | | | | OLIVIER CANTON | E SHKALLËS MË TË ULËT A E CAKUT MË TË POSHTËM | ZANORE | TRANSMISI. ELECTRON MICROSCOPE | REGJISORI AMERIKANE STONE (shq.) | GATESË E JONA TRADICIONA-LE | ROTERDAM / E KAPA ME DORË (bised.) | | | AUSTRIA, LETONIA / GRUP MUZIKOR (shq.) | | |
| BASHKË, TOK | | | TINGULLIMIT-IM, FJALË TINGULLIMITUESE / MËNJANIMI NGA GARA | | | | | | | | | | LLOJ PAPAGALLI | BASHKËTING-ËLLORE / BOLTON | | BOLIVIA / DIREK I ÇATISË | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARI YNË AGIM / HEROI PRISHTINA | | | | | | | KËNGËTARJA SHQIPTARE MARKU / KËNGËTARJA FARA | | | | | | | | | |
| BASHKËTING-ËLLORE | | ISLAM (perkdh.) / SATANI, DJALLI | | | | QË KA MBETUR PA GOJË NGA HABIA, I SHTANGUR, I ....... / DAVID AGUER | | | | | | | | “R” në mes të dy “N” / PËRÇARJE | | | |
| SHKRIMTARI ASLLANI | | | | JETË PA TRAZIME, JETË E QETË DHE E LUMTUR / INTER TOTO | | | | | PJESA E DALË NË TRAJTËN E NJË BALLKONI TË GJERË PËRPARA NJË NDËRTESE / ROBEN AGOS | | | | | | | | LUTJA NË TË CILËN PRIFTI SHPREH DISA DËSHIRA PËR BESIMTARËT |
| NJË NGA VËLLEZËRIT FRASHËRI | | | | | EMËR FEMRE MYSLIMANE / FUTBOLLISTI ANGLEZ .... LENON (Totenham) | | | | | | AKTORI YNË ISLAMI (shq.) / REKUIZITË SPORTIVE | | | | | ZANORE / BANOR I HERSHËM I NJË KRAHINE A I NJË VENDI | |
| KËNGËTARJA AMERIKANE BAKER | | | | | | ZANORE / EVERTON | | VEPRIMTARI KRIJUESE ARTISTIKE / ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER | | | | ALI ALIU / SYLEJMAN (perkdh.) | | | DUKAT / KËNGËTARJA E FAMSHME SKOCEZE LENOKS | | |
| PJESË E LIGJIT | | | | DRAMATURGU ARBËRESHË JOSIP / “MOLDAVIA” | | | | | INTERNATIO. ORGANIZATI-ON FOR MIGRATION / ALUMIN | | | | ISH PILOTI I “Formula 1” AIRTON / PËREMËR VETOR | | | | |
| EPOKA E RE | AKTORI YNË FLLOKO / SHKRONJA E 16-të | | | | | SUPER MODELJA HERZIGOVA / ZANORE | | | | KËPUCËT E POSAÇME PËR TË RRËSHQITUR MBI AKULL / TUNIZIA | | | | | | | |
| AGRUME ME GJETHE GJITHNJË TË GJELBRA (shq.) | | | | | | | FUTBOLLISTI ..... LALA (shq.) | | | | | | | REGJISORI QOSJA | | | |

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: UNITET, E KAMUR, LAK, KOSOVA, DAMAT, KNA, SHRM, O, RIFAT, KAMAT, IME, KRUTAN, FATALE, NATIRUM, ZILET, TET, H, IM, AB, TE, ORIZ, LOQ, T, TAROT, ILET, IRENA, ZEMËR, INIS, NATALI, ATI, I, ATILA, DEKO, ONIRA, ETAPA, RI, AL, ME, ONOMATOPE, B, B, TEJECI, ELIZABETA, H, LAM, NEMITUR, NRN, ALI, IDIL, VERANDA, SAMI, AMIRE, ARDI, U, ANITA, A, ART, AA, AR, NEN, RELA, IOM, SENA, TIMO, EVA, PATINAT, LIMONI, ALTINI, ISA .

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria–Vlada-Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*

*Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin "Tourism EXPO Japan 2018" në Tokio , Japoni, më 20-23 shtator 2018**

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA, e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e dy (2) subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 29.06.2018 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Për të aplikuar duhet dorëzuar:
   - 1.1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues; dhe
   - 1.2. Dokumentet e kërkuara.

2. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:
   - 2.1. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
   - 2.2. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
   - 2.3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues, nëse personi i autorizuar është i ndryshëm nga pronari i subjektit aplikues, ju lutem bashkëngjitni autorizimin e noterizuar;
   - 2.4. Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime, kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
   - 2.5. Dëshmi që subjekti aplikues nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjygjësor të lëshuar nga Gjykata Themelore, kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
   - 2.6. Produktet turistike të ofruara turistëve gjatë vitit 2017;
   - 2.7. Deklaratën nën betim; dhe
   - 2.8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

3. Dy (2) subjektet pjesëmarrëse do të përzgjidhen sipas kritereve të veçanta në vijim dhe rangimit të pikëve:
   - 3.1. Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve gjatë vitit 2018, maksimum dhjetë (10) pikë: një (1) pikë për një (1) produkt turistik inbound, tre (3) pikë për dy produkte turistike inbound, pesë (5) pikë për tri (3) produkte turistike inbound, shtatë (7) pikë për katër (4) produkte turistike inbound dhe dhjetë (10) pikë për pesë (5) e më shumë produkte turistike inbound;
   - 3.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit pjesëmarrës në panair, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: gjuha Angleze pesë (5) pikë, gjuha Japoneze katër (4) pikë dhe gjuhët tjera një (1) pikë;
   - 3.3. Materiale promovuese në gjuhët e huaja, maksimum dhjetë (10) pikë kumulative: në gjuhën Angleze pesë (5) pikë dhe pesë (5) pikë në gjuhën Japoneze;
   - 3.4. Aktiviteti primar turistik i subjektit, maksimum dhjetë (10) pikë: agjencion turistik katër (4) pikë dhe tour operatorë dhjetë (10) pikë;

Më 26.06.2018, në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, zyrtarët e KIESA-s do tu përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 29.06.2018 në zyrën e Arkivit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rruga Muharrem Fejza, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MTI apo të shkarkohen nga faqet e internetit mti.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën export.kiesa@rks-gov.net.

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

***Qeveria***

***Vlada - Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*

*Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)

U cilju promovisanja turističkih potencijala Kosova, Ministarstvo Trgovine i Industrije putem Agencije za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA), objavljuje:

**Javni poziv za apliciranje štandu Kosova na sajmu**

**"Tourism EXPO Japan 2018" u Tokiju, Japan, od 20 - 23 septembra 2018**

Državna prezentacija se organizuje od strane Ministarstva Trgovine i Industrije, odnosno Kosovske Agencije za Investicije , koja pokriva troškove izložbenog prostora, izgradnje štanda, registracije dva (2) , troškove električne energije .

Molimo obratite pažnju da se samo izražena interesovanja poslata do 29.06.2018 i samo u potpunosti popunjene aplikacije se mogu uzeti u obzir za ocenjivanje.

1. Da biste aplicirali treba dostaviti:
   - 1.1. Aplikacija popunjena osnovnim podacima subjekta koji se prijavljuje; i
   - 1.2. Potrebni dokumenti.

2. Potrebni dokumenti za apliciranje:
   - 2.1. Dokaz da je aplikant registrovan u Republici Kosovo;
   - 2.2. Dokaz o aktivnom računu u jednoj od banaka licencirana od strane Centralne Banke Kosova;
   - 2.3. aplikanta, ako je aplikant , molimo vas priložite noterizovano ovlašćenje;
   - 2.4. Uverenje Suda kojom se , zahteva se original koji nije stariji od 30 dana;
   - 2.5. Dokaz da aplikant nije pod falimentacijom ili pod nasilnom sudskom upravom izdat od strane Osnovnog Suda, zahteva se original koji nije stariji od 30 dana;
   - 2.6. Turistički proizvodi ponuđeni turistima tokom 2017;
   - 2.7. Izjava pod zakletvom; i
   - 2.8. Poresko uverenje aplikanta o izvršenim obavezama prema Poreskoj Administraciji Kosova, ne stariji od šest (6) meseci.

Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog dokumenta koji se zahteva na gore navedenoj listi, aplikacija aplikanta će biti diskvalifikovana i neće se dalje razmatrati za specifične kriterijume navedene u nastavku.

3. Dva (2) učesnika bit će odabrano prema sledećim specifičnim kriterijumima i tačkama rangiranja:
   - 3.1. Inbound turistički proizvodi koji će se ponuditi turistima tokom 2018 godine, maksimalno deset (10) poena: jedan (1) poen za jedan (1) inbound turistički proizvod, tri (3) poena za dva inbound turističkih proizvoda, pet (5) poena za tri (3) inbound turističkih proizvoda, sedam (7) poena za četiri (4) inbound turističkih proizvoda i deset (10) poena za pet (5) ili više inbound turističkih proizvoda;
   - 3.2. Poznavanje stranih jezika i veština prezentacije predstavnika subjekta koji učestvuju na sajmu, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: Engleski jezik pet (5) poena, Japanski jezik četiri (4) poena i drugi jezici jedan (1) poen;
   - 3.3. Promotivni materijali na stranim jezicima, maksimalno deset (10) kumulativnih poena: na Engleskom pet (5) poena i pet (5) poena na Japanskom jeziku;
   - 3.4. Primarna turistička aktivnost subjekta, maksimalno deset (10) poena: turistička agencija četiri (4) poena i turoperatori deset (10) poena;

Dana 26.06.2018, u 14:00 časova, u sali za sastanke KIESA, službenici KIESA će odgovoriti na pitanja o sajamskoj organizaciji i podršci kompanijama za učešće na ovom sajmu. Subjektima kojima je potrebna asistencija u popunjavanju ovog obrasca savetuje se da takođe prisustvuju ovom sastanku.

Subjekti koji žele da apliciraju za učešće na sajmu treba da izraze svoje interesovanje popunjavanjem aplikacije i poslati najkasnije do 29.06.2018 u kancelariji Arhive Ministarstva Trgovine i Industrije, ul. Muharrem Fejza, b.br. Priština, 10000, Republika Kosovo.

U trenutku apliciranja, subjekat prihvata sve odgovornosti, obaveze, kriterije i dužnosti predviđene važećim zakonima i posebnim kriterijumima predviđenim u ovom javnom pozivu.

Informacije i upitnik za izražavanje interesovanja mogu se dobiti na KIESA-MTI ili preuzeti sa veb stranice mti.rks-gov.net i kiesa.rks-gov.net ili na e-mail adresi export.kiesa@rks-gov.net.




RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

TrafikuUrban

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënjen në Punë, Vendimi nr.110 të dates 20.06.2018 të KE, N.P.K."Trafiku Urban" SH.A.- Prishtinë, më date 21.06.2018 shpall:

# K O N K U R S

**Pozita e punës:** Zyrtar Ligjor (1 pozitë).

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit, me mundësi vazhdimi.

**Orari i punës:** I plotë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

-Asiston në përpilimin e rregulloreve dhe akteve tjera të ndërmarrjes;

-Me kërkesë të udhëheqësit përgatitë vendime, shkresa, parashtresa për ndërmarrjen;

-Me kërkesë të udhëheqësit, harton kontrata, marrëveshje dhe memorandume për nevoja të ndërmarrjes;

-Ndihmon sekretarin në ofrimin e këshillave ligjore dhe bën hulumtime ligjore për nevoja të ndërmarrjes;

- Kujdeset për përgatitjen, shtypjen e materialeve të mbledhjeve dhe shpërndarjen e tyre.

- Mban procesverbalin e mbledhjeve të menaxhmentit dhe komiteteve të tjera në rast nevoje.

-Bën rregullimin e dosjeve dhe mban regjistrin e tyre.

- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga udhëheqësi.

- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative të brendshme.

- Për kryerje e detyrave dhe përgjegjësive i përgjigjet sekretarit të ndërmarrjes.

**Përgatitja profesionale**

-Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, niveli i studimeve Master.

-Përvojë pune 3 vjeçare, preferohet në institucione me status juridik të njëjtë apo të përafërt.
-Aftësi pune me kompjuter e domosdoshme

- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese.

-Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punojë nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

Kandidati, duhet t`i dorëzoj këto dokumente në formë të skenuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga ueb-faqja e TU-së http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html)

2. Letër motivuese

3. Kopja e letërnjoftimit.

4. Kandidati së bashku me aplikacionin duhet të dorëzojnë edhe vërtetimin nga gjykata kompetente se i njëjti nuk është nën hetime – jo më të vjetër se 6 muaj.

Kandidatët të cilët kalojnë në fazën e intervistës duhet t'i dëshmojnë të dhënat e paraqitura në aplikacion në kopje fizike.

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

-Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **21.06.2018** dhe përfundon më datë **05.07.2018** në ora 24:00

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara dhe të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

N.P.K ''Trafiku Urban'' SH.A.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Luljeta Milazim Humolli shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës

▶ Shoqata e Industrisë së Qumështorëve të Kosovës (SHIQK) shpall të pavlefshëm certifikatën me numër fiskal 600523741 - Prishtinë

▶ Rrahim Tahiri shpallë të pavlefshme diplomën dhe dëftesën e "QAAEMO" në Mitrovicë.

▶ Filloret Syla, shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës fillore "Asim Vokshi" Prishtinë.

▶ Anila Rystemi shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ganimete Tërbeshi" Blaç Dragash.

▶ Fatjan Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shf "Zenel Hajdini" Prizren.

▶ Fitim Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Zenel Hajdini" Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përballë Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

▶ Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333